

**Autorë:** Vera Koburska  
Festa Lena  
Emilia Dimitrova

# **KONSTRUKSIONET E ÇELIKUT për vitin IV**

drejtimi ndërtimtari - gjeodezi  
teknik i ndërtimtarisë

teknik

Shkup, 2011

**Autorë:** Vera Koburska  
Festa Lena  
Emilia Dimitrova

**Recensentë:**

Prof. dr. Petar Cvetanovski, Fakulteti i Ndërtimtarisë, Shkup  
Lida Trajkovska, shshgj  
Sonja Stefanovska, shshgj

**Përkthyes:** Bajram Selmani

**Redaktor i botimit në gjuhën shqipe:** Prof. dr. Hamit Mehmeti

**Lektor:** Abdulla Mehmeti

**Përgatitja kompjuterike:** Autorët

**Fotografite dhe redaktimi teknik:** Autorët

**Botuesi:** Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë

**Shtypi:** Graficki centar dooel, Shkup

**Tirazhi:** 150

Me vendim për miratimin e këtij libri nga lënda Konstrukcionet e çelikut për vitin e katërt, Drejtimi:ndrëtimtari-gjeodezi; profili; teknik i ndërtimtarisë nr.22-1265/1 nga 13.07.2011 e sjellur nga Komisioni kombëtar për libra.

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св.Климент Охридски,, , Скопје  
691.71 (075.3)

КОБУРСКА, Вера  
Челични конструкции за IV година :градежен техничар / Вера Кобурска, Феста Лена,  
Емилија Димитрова. - Скопје : Министерство за образование и наука на Република  
Македонија, 2011. - 204 стр.: илустр. ; 26 см

ISBN 978-608-226-319-9

1. Лена, Феста (автор) 2. Димитрова, Емилија (автор)  
COBISS.MK-ID 89143306



## PARATHËNIE

Libri „Konstruksionet e çelikut“ është libri i parë në Maqedoni, i dedikuar për nxënësit e shkollave të mesme profesionale, të profilit arsimor teknik i ndërtimtarisë.

Në libër janë përfshirë dhe janë përpunuar tërësitë tematike të parapara me **programin** mësimor të lëndës **Konstruksionet e çelikut** për nxënësit e vitit të katërt.

Qëllimi i këtij libri është që përmes nëntë tërësive tematike të përpunuara në detaje, më lehtë ta zotërojnë materien dhe të fitojnë njohuri të përgjithshme dhe profesionale nga fusha e vetive themelore të konstruksioneve të çelikut, prodhimi i çelikut, llojet e çelikut në ndërtimtari, profilet e çelikut dhe përpunimi i tyre në punëtori, mjetet lidhëse në konstruksionet e çelikut (farkimet, vidhat dhe saldimet), konstruksioni dhe përlllogaritja e lidhjeve, konstruksioni i bartësve të rrjetave, shtyllat e çelikut dhe trarët mbajtës të mureve të plota.

Libri është shkruar në mënyrë që të jetë i kuptueshëm dhe pranueshëm për nxënësit nga viti i katërt i profilit arsimor, teknik i ndërtimtarisë, kështu edhe për teknikët tani më të mbaruar që dëshirojnë t'i freskojnë dhe thellojnë njohurit e tyre të fituara gjatë shkollimit. Gjithashtu, librin mundet ta përdorin edhe teknikët nga fushat e afërta që dëshirojnë të bëjnë rikualifikim ose kualifikim nga kjo fushë.

Përmbajta e librit dhe stili me të cilin është shkruar ju mundëson profesorëve përshtatje të lehtë dhe fleksibilitet gjatë mbajtjes së orës. Kalimi prej kapitullit në kapitull është i thjeshtë, me qasje të kujdesshme të teorisë dhe praktikës, kurse me qëllim që libri të jetë i lexueshëm lehtë dhe thjeshtë për t'u kuptuar. Libri, gjithashtu, përmban edhe një numër të madh fotografish që e pasurojnë dhe kontribuojnë më mirë të ilustron koncepti i tërësive programore dhe ideja e autorëve. Qasja e këtyre mundëson që nxënësit në mënyrë më të lehtë dhe të thjeshtë ta përvetësojnë materien që ligjërohet dhe në mënyrë më të lehtë dhe thjeshtë të pajisen me njohuritë e domosdoshme nga kjo fushë.

Autorët ju shprehin falënderime recensentëve të librit për këshillat dhe sugjerimet e dobishme të dhëna gjatë formimit përfundimtar të librit. Posaçërisht e falënderojmë prof. dr. Atanas Filipovskin nga Fakulteti i Ndërtimtarisë, për sugjerimet dhe përkrahjen gjatë përgatitjes së këtij teksti. Gjithashtu, do t'u jenë falënderues të gjithë lexuesve që do të ndihmojnë me sugjerime e tyre për lëshimet eventuale të librit dhe do të japin sugjerime për përmirësimin e tij gjatë botimit të dytë eventual.



## PËRMBAJTJA

<b>1.</b>	<b>VETITË THEMELORE TË KONSTRUKSIONEVE TË ÇELIKUT</b>	<b>1</b>
<b>1.1</b>	<b><i>Konstruksionet prej çelikut</i></b>	<b>1</b>
<b>1.2</b>	<b><i>Bazat e konstruksioneve të çelikut</i></b>	<b>4</b>
<b>1.3</b>	<b><i>Përparësitë dhe mangësitë e konstruksioneve të çelikut</i></b>	<b>4</b>
1.3.1	Përparësitë e konstruksioneve të çelikut	4
1.3.2	Dobësitë e konstruksioneve të çelikut	6
<b>2.</b>	<b>PRODHIMI I ÇELIKUT</b>	<b>9</b>
<b>2.1</b>	<b><i>Përfitimi i hekurit</i></b>	<b>9</b>
<b>2.2</b>	<b><i>Përfitimi i çelikut</i></b>	<b>11</b>
2.2.1	Konvertori Tomasov – Besmerov	11
2.2.2	Procesi i Simens – Martenovit	12
2.2.3	Përfitimi i çelikut në furra elektrike	13
<b>3.</b>	<b>LLOJET E ÇELIKUT TË NDËRTIMTARISË</b>	<b>15</b>
<b>3.1</b>	<b><i>Llojet e çelikut të ndërtimtarisë</i></b>	<b>15</b>
3.1.1	Çeliku i konstruksionit	15
<b>3.2</b>	<b><i>Shenjat e çelikut të ndërtimtarisë</i></b>	<b>17</b>
3.2.1	Çeliquet me veti mekanike të vërtetuara	18
3.2.2	Çeliquet me përbërje të vërtetuar kimike dhe veti mekanike	19
<b>4.</b>	<b>PROFILET E ÇELIKUT DHE PËRPUNIMI NË PUNËTORI</b>	<b>21</b>
<b>4.1</b>	<b><i>Format e prodhimit të çelikut</i></b>	<b>21</b>
<b>4.2</b>	<b><i>Shkopinjë</i></b>	<b>22</b>
<b>4.3</b>	<b><i>Lastrat</i></b>	<b>25</b>
<b>4.4</b>	<b><i>Profilet e çelikut</i></b>	<b>28</b>
4.4.1	Profilet e rrokullisura të nxehtë	28
4.4.2	Formësimi i ftohtë i profileve	30
<b>4.5</b>	<b><i>Përpunimi i pjesëve të çelikut në punëtori</i></b>	<b>31</b>
4.5.1	Drejtimi i lastrave dhe profileve	31
4.5.2	Lakimi i elementeve të çelikut	31
4.5.4	Shënimi	32
4.5.4	Prerja e lastrave	32
4.5.5	Përpunimi i teheve	34
<b>4.6</b>	<b><i>Përpunimi i vrimave për gozhdim dhe vida</i></b>	<b>35</b>
<b>4.7</b>	<b><i>Përpunimi i elementeve në punëtori</i></b>	<b>35</b>
4.7.1	Shënimi i elementeve	36
<b>4.8</b>	<b><i>Mbrojtja e konstruksioneve të çelikut nga korrozioni</i></b>	<b>36</b>

<b>5.</b>	<b>MJETET PËR LIDHJE (MJETET LIDHËSE) NË KONSTRUKSIONET E ÇELIKUT</b>	<b>43</b>
5.1	<i>Farkimet</i>	43
3 5.1.1	Shenjat e farkimit	46
5.2	<i>Vidat</i>	48
5.3	<i>Ngjitjet e salduara</i>	50
5.3.1	Shenjat e saldimit	53
5.3.2	Realizimi i saldimeve	55
5.3.3	Rreziqet nga saldimi elektrik	58
5.3.4	Masat mbrojtëse	59
5.3.5	Gabimet në saldime	59
<b>6.</b>	<b>KONSTRUKSIONI DHE PËRLLOGARITJA E LIDHJEVE (MBISHTESA)</b>	<b>63</b>
6.1	<i>Llojet e mbishtesave</i>	63
6.2	<i>Mbi dhënia e lamelave</i>	65
6.3	<i>Lidhjet e bëra me gozhdim dhe vida të zakonshme</i>	67
6.4	<i>Puna e lidhjes së farkuar gjatë ngarkimit statik</i>	71
6.5	<i>Përllogaritja e dredhimeve të salduara</i>	74
6.6	<i>Lidhjet e ngarkuara aksiale</i>	76
6.7	<i>Ngritja e këndeve</i>	78
6.8	<i>Ngritja e trarëve bartës të profiluar</i>	80
<b>7.</b>	<b>KONSTRUKSIONI I TRARËVE BARTËS TË GRILAVE</b>	<b>85</b>
7.1	<i>Karakteristikat e trarëve bartës të grilave</i>	85
7.1.1	"P" trarët bartës	85
7.1.2	Grilat trekëndëshe	86
7.1.3	Grilat trapeze	88
7.1.4	Grila trekëndëshe me zgjatje	89
7.1.5	Grila trapeze me diagonale dhe vertikale të posaçme	89
7.1.6	Grila me breza paralele dhe brezërat poligonale	89
7.1.7	Mbrehja e grilave	90
7.1.8	Konstruksione grilash nga sistemet e ndryshme konstruktuese	91
7.1.9	Grilat hapësinore	92
7.2	<i>Konstruktimi i nyjave në grila</i>	96
7.2.1	Nyjat nga grilat të realizuara me lastra ngjitëse	96
7.3	<i>Centrimi i shkopinjeve me nyjat e grilave</i>	97
7.4	<i>Lastra nyjore dhe formësimi i saj</i>	98
7.4.1	Nyjat nga grilat me nyje lastrash	98
7.4.2	Grila prej gypave me nyje lastrash	101
7.4.3	Nyjat prej grilave pa nyje lastrash	102
7.4.4	Grila prej gypave pa nyje lastre	104
7.5	<i>Grila hapësinore</i>	105

<b>8.</b>	<b>SHTYLLAT</b>	<b>107</b>
<b>8.1</b>	<b><i>Përgjithësisht për shkopinjtë si elemente të konstruksioneve të çelikut</i></b>	<b>107</b>
<b>8.2</b>	<b><i>Shkopinjte e zgjatur</i></b>	<b>107</b>
8.2.1	Konstruksioni i shkopinjve të zgjatur	108
8.3	Shkopinjte e shtrënguar – shtyllat	109
<b>8.2</b>	<b><i>Llojet e shtyllave si element edhe në konstruksione</i></b>	<b>112</b>
<b>8.3</b>	<b><i>Lidhja e shtyllës dhe themeli</i></b>	<b>114</b>
8.3.1	Lidhja e gërshetuar	114
8.3.2	Lidhja e nyjave	116
	Shembuj për përlogaritjen e shtyllave me centrim të shtrënguara	117
	Shembujt e zgjedhur nga trarët bartës të grilave	123
<b>9.</b>	<b>TRARËT BARTËS TË MUREVE TË PLOTA</b>	<b>129</b>
<b>9.1</b>	<b><i>Zbatimi dhe forma e trarëve bartës të mureve të plota</i></b>	<b>129</b>
<b>9.2</b>	<b><i>Karakteristikat dhe format e trarëve të mureve të plota bartës</i></b>	<b>129</b>
<b>9.3</b>	<b><i>Përcaktimi i dimensioneve në prerjet të trarët bartës të lastrës</i></b>	<b>134</b>
9.3.1	Përcaktimi i lartësisë minimale të trarit bartës të lastrës	135
9.3.2	Sigurimi i stabilitetit i lastrës vertikale kundra gungave	136
<b>9.4</b>	<b><i>Trarët bartës të lehtësuar – trarët bartës në lastrën me vrima, lastrën vertiluar</i></b>	<b>139</b>
	Shembuj të zgjedhur për trarët bartës të mureve të plota	144
<b>10.</b>	<b>SHTOJCA</b>	<b>149</b>
	Literatura e shfrytëzuar	196



# 1. VETITË THEMELORE TË KONSTRUKSIONEVE TË ÇELIKUT

## 1.1 Konstruksionet e çelikut

Çeliku është material i cili është çdoherë modern dhe aktual, material i të sotmes dhe të ardhmes. Ai është material me mundësi të pakufizuara. Është i shkëlqyeshëm për objekte reprezentative dhe industriale, ngase me procese të vogla zotërohen me distanca të mëdha, përkatësisht ngarkesa të mëdha. Ai është i material i përshtatshëm dhe me përpunimin e tij industrial mundësohet montim i konstruksioneve të çelikut në periudhë të shkurtë kohore.

Në të njëjtën kohë, çeliku është material i ekologjisë sepse mund të riciklohet pafundësisht, pa u humbur ndonjë nga kualitetet e tij.

Sot, në vendet e zhvilluara industriale, çeliku paraqet material ndërtimor pa të cilin nuk mund të mendohet ndërtimi i asnjë objekti të njohur.

Aplikimi i çelikut në konstruksionet e ndërtimitarisë, nga aspekti i inxhinierisë-konstruksionit, ka arsytim të plotësishëm. Në faqet vijuese janë dhënë objekte karakteristike të realizuara prej çeliku: ura e parë e çelikut mbi lumin Severn në Angli (fig. 1.1), objekt çeliku (fig. 1.2.), salla sportive „Boris Trajkovski”, në Shkup (fig. 1.3) përkatësisht:

- objekte nëntokësore dhe mbitokësore;
- salla me distanca të mëdha (salla industriale);
- ura;
- oxhaqe fabrikash;
- tunele;
- objekte hidroteknike;
- qendra tregtare;
- termoelektrana;
- shtylla largpërçuesish dhe të antenave;
- salla sportive dhe të tjera.




Fig. 1.1 Ura e parë e çelikut mbi lumin Severn në Angli, në vitin 1776, distanca e urës 31,0 metra



Kulla e Ajfelit në Paris



Ura hekurudhore



Ura e çelikut



Shtyllat e antenave



Kantier anijesh



Largçues

Fig.1.2 Objekte nga çeliku





Fabrikë



Termoelektrana




Fig.1.3 Qendra sportive "Boris Trajkovski"-Shkup

## 1.2 Bazat e konstrukcioneve të çelikut

**Bazat e konstrukcioneve të çelikut** dalin prej vetive të çelikut si material ndër-timor. Çeliku paraqet material homogjen me strukturë homogjene dhe veti të njëjta mekanike në të gjitha drejtimet. Çeliku është material i qëndrueshëm që duron de-formime elastike dhe plastike.

### Vetitë më të rëndësishme të çelikeve janë:

- kufiri i tërheqjes;
- fortësia e këputjes;
- rezistenca gjatë ndërprerjes;
- kontraktioni;
- qëndrueshmëria;
- ngurtësia.

#### Mbaje mend:

**Çeliku është material homogjen me strukturë homogjene dhe veti me-kanike të njëjta në të gjitha drejtimet.**

#### Pyetje:

Ku gjen zbatim çeliku?

Numëroi vetitë mekanike të çelikut?

Cila sallë sportive, në afërsi të shkollës, është ndërtuar prej çeliku?

#### Detyra:

Së bashku me mësimdhënësin, në rrethinën ku jeton, vizito objekt të ndërtuar prej çeliku, vështroi, vëreji karakteristikat dhe diskuto!

## 1.3 Përparësitë dhe dobësitë e konstrukcioneve të çelikut

Konstruktionet e çelikut kanë përparësitë dhe dobësitë e veta.

### 1.3.1 Përparësitë e konstrukcioneve të çelikut janë:

- fortësia e madhe;
- moduli i lartë i elasticitetit;
- vetitë e ezotropisë.

## Fortësia e madhe

Çeliku dallohet me fortësi të madhe. Sipas standardeve tona, shtrëngimet e lejuara për çelikon e rëndomtë ÇH 240, për ngarkimet themelore, shtrëngimet e lejuara arrijnë  $\sigma_{doz} = 160 \text{ MPa}$ .

Krahasimin e çelikut me fortësinë e drurit dhe betonit e vështrojmë në një shtyllë të shkurtër të shtrënguar, me lartësi  $h$  dhe prerja pa ndalur  $A$ , e ngarkuar me forcë aksiale të presionit  $N$  (fig. 1.2).

### Shtrëngimi i forcës aksiale arrin:

$$\sigma_{\max} = \frac{N}{A} \leq \sigma_{doz} \quad 1.1$$

### Volumeni i shtyllës është:

$$V = Ah \quad 1.2$$

Ku :

$V$  – vëllimi i shtyllës

$A$  – prerja tërthortë

$h$  – lartësia e shtyllës

### Pesha është:

$$g = V \cdot \gamma \quad 1.3$$

$g$  – pesha e shtyllës

$V$  – vëllimi i shtyllës

$\gamma$  – pesha e vëllimit




Fig. 1.2. Shtylla e shkurtër e ngarkuar me forcë aksiale të presionit

Nga shprehjet 1.2 dhe 1.3 fitojmë se është:

$$A = \frac{g}{h\gamma} \quad 1.4$$

Shprehjen 1.4 e zëvendësojmë me barazimin 1.1 dhe fitojmë:

$$\sigma_{\max} = \frac{Nh\gamma}{g}$$

Nga ku rrjedh:

$$g = Nh \frac{\gamma}{\sigma_{doz}}$$

Krahasimi i fortësisë së këtyre tri materialeve: çelik, dru, beton, është dhënë në tabelën 1.1

Tabela 1.1

	Çelik ÇN 240	Dru klasa II	Beton MB 30
$\gamma$ (kg/m <sup>3</sup> )	7850	800	2450
$\sigma_{doz}$ (MPa)	160	10	12
$\gamma/\sigma_{doz}$	49	80	204
$g$ (%)	100%	163 %	416 %

**Nga tabela shihet se një konstrukcion i njëjtë me karakteristika të njëjta gjeometrike, i realizuar nga çeliku, është më i lehtë për katër herë nga ajo e realizuar prej betoni dhe 1,6 herë më e lehtë nga druri.**

### **Modul i lartë i elasticitetit**

Moduli i elasticitetit (Moduli i Jungut) për çelikun merret të jetë  $E_c=210000\text{MPa}$ .

Modulet e elasticitetit janë për:

- alumin  $E_{al} = 70.000 \text{ MPa}$
- beton  $E_b = 21.000 \text{ MPa}$
- dru  $E_d = 10.000 \text{ MPa}$

E shikojmë me kujdes trarin e thjesht nga çeliku dhe alumini.

Për zotërimin e pjerrtësisë maksimale të trarit të përpunuar prej **alumini** është e nevojshme lartësi më madhe e prerjes së tërthortë, për 1,5 deri më 2 herë nga tri i tillë i njëjtë i përpunuar prej **çelikut**. Ky dallim rrjedh prej moduleve të ndryshme të elasticitetit të aluminit dhe çelikut.

### **Vetitë e ezotropisë**

Vetitë e një materiali që të ketë shtrëngime të njëjta në të gjitha drejtimet quhet **ezotropi**.

**Për konstruktionet e çelikut shtrëngimet e lejuara të presionit dhe shtrirjes janë të njëjta sipas vlerës absolute.**

**Te druri dhe betoni këto shtrëngime janë me vlerë të ndryshme.**

### **1.3.2 Mungesat e konstrukcioneve të çelikut:**

- jo rezistueshmëria e korrozionit;
- jo rezistenca në temperatura të larta.

## Jo rezistenca ndaj korrozionit

Korrozioni mund të definohet si asgjësim i metalit gjatë reaksionit kimik ose elektrokimik me mjedisin e tij.

Ekzistojnë çelique që janë legura me elemente të caktuara, si: kromi, nikeli dhe të tillët nuk ndryshken.

Në varshmëri nga shkalla e korrozionit rrjedh domosdoshmëria e mbrojtjes së konstrukcioneve të çelikut, në punëtori, para montimit, pas montimit dhe gjatë ekspluatimit të tij.

Mbrojtja nga korrozioni mund të bëhet me lyerjen natyrore me vernik mbrojtës. Verenikët mund të jenë **metalik** dhe **jometalik**.

Më së shumti zbatohen verenikët metalik edhe atë, **miniumi dhe cinkoliti**.

## Pastrimi i konstrukcionit kryhet në disa makina:

- me rërë;
- pastrimi me dorë, me furçe çeliku;
- pastrimi me flakërim.

**Rërësimi** bëhet në fabrikën ku prodhohet çeliku. Qëndron në pastrimin e sipërfaqës së çelikut me reaktiv abraziv me **presion të lartë**.

Abrazivi përbëhet prej kokërave të çelikut me diametër prej 0,5 deri me 1,2 mm ose me rërë kuarci në presion prej 6 deri më 8 bar.

**Pastrimi me furçe çeliku bëhet me dorë** dhe zbatohet për sipërfaqe të vogël që janë të dëmtuara prej korrozionit.

**Pastrimi me flakërim** bëhet me nxehje deri më 150°C, kurse zbatohet për sipërfaqe më të vogël.

Pas pastrimit të konstrukcionit bëhet lyerja **me lyerjen themelore (minizirimi)**.

Pas kryerjes së minizirimit dhe terjes mirë të miniumit **vihet ngjyra mbrojtëse në një ose dy shtresa (lyerja mbrojtëse)**.

## Mbrojtja e konstrukcioneve të çelikut bëhet edhe me zinkim.

Zinkimi zbatohet për mbrojtje nga korrozioni te shtyllat e largpërçuesve, antenave dhe konstrukcioneve montuese.

## Jo rezistues ndaj temperaturave të larta

Veti negative e çelikut është se moduli zvogëlohet gjatë temperaturave të larta.

*Mbrojtja e konstrukcioneve të çelikut nga zjarri bëhet në disa mënyra:*

- mveshja me beton;
- me materiale termoizoluese;
- lesh mineral (tervol);
- perde prej çeliku të kromuar, që është rezistent ndaj temperaturave të larta.

## Çeliku është deficitar

Çeliku është material shumë i kërkuar, jo vetëm për konstrukcione por edhe në industri. Nga çeliku i prodhuar, vetëm 30% shfrytëzohet në ndërtimtari, ndërsa pjesa tjetër përdoret për qëllime të tjera.

Gjatë projektimit të konstrukcioneve të çelikut duhet të merren parasysh parimet themelore vijuese:

- konstrukcioni t'i përgjigjet dedikimit;
- të jetë ekonomik;
- të jetë i qëndrueshëm dhe i sigurt gjatë eksploatimit;
- t'i plotësojë normat arkitektonike.

### **Mbaje mend:**

**I njëjti konstrukcion me karakteristika të njëjta gjeometrike i ndërtuar prej çelikut është më i lehtë për 4 herë nga konstrukcioni i betonit dhe për 1,6 nga i drurit.**

Pyetje:

Numëroji përparësitë e konstrukcioneve të çelikut!

Numërtoji dobësitë e konstrukcioneve të çelikut!

Definoje çka është korrozioni?

Çka është ezotropia?

Si bëhet mbrojtja e konstrukcioneve të çelikut nga zjarri?

Numëroji llojet e mbrojtjes së konstrukcioneve të çelikut prej korrozionit!

Detyra:

Përcakto mbrojtje nga korrozioni të konstrukcioneve të çelikut në varshmëri nga shkalla e korrozionit!

## 2. PRODHIMI I ÇELIKUT

### 2.1 Përfitimi i hekurit

Hekuri fitohet me shkrirjen e xehes së hekurit në furnnalta. Çeliku paraqet prodhim të pastruar nga xehja e hekurit. Xehet e hekurit që përdoren për prodhimin e hekurit hasen me emrat vijues:

- magnetiti (oksid hekuri me 75% hekur);
- hematiti (oksid hekuri me 70% hekur);
- sideriti (hekur karbonat, përmban prej 45% deri 50% hekur);
- piriti (sulfat hekuri, me më pak se 40% hekur) dhe të tjerë.

Furnnalta (fig. 2.1.) ka formën e konusit dyanshëm të prerë i lartë deri më 50 m dhe diametrit të hapjes së pastërtë 9 metra për fura me kapacitet mesatar.




Fig. 2.1. Fitimi i hekurit në furnnalta

Fura mbushet prej lartë njëtrajtësisht me xehë, koks dhe gjelqere.

Në pjesën e poshtme të furrës janë vendosur fryrjet për ajër që procesi i djegies të zhvillohet sa më shpejtë. Koksi digjet dhe me këtë rast e merr oksigjenin nga xehja e oksigjenit. Në procesin e djegies zhvillohet temperaturë prej rreth 1700°C me ç'rast krijohen gazra të ndryshëm, si dioksidi i karbonit dhe azoti që shfrytëzohen për stërnxehje të procesit të fitimit të hekurit. Hekuri i shkrirë bie më rëndë në fund të furrës, përderisa gjelqerja kompozohet me materiet të tjera të patretshme dhe në formë të zgurës ose bramcë noton në sipërfaqe.

Përmes vrimës speciale zgura derdhet dhe të njëjtës i shtohen të dhëna të ndryshme dhe si e tillë ka zbatim të madh në industrinë e çimentos për përpunimin e asfalt-betonit, dyshemes rezistuese ndaj topitjes dhe të tjera.

Një furnaltë mund për 24 orë të prodhohen deri më 2000 tonë hekur të papërpunuar. Furnalta punon vazhdimisht, kurse pushon së punuari vetëm gjatë kohës së remontit.

Nga furnalta zakonisht fitohen dy lloje të hekurit, edhe atë:

- **hekur i bardhë,**
- **hirit i papërpunuar.**

**Hekuri i bardhë** fitohet me ftohje të shpejtë, ndërsa hekuri i kaltër i papërpunuar fitohet me ftohje të ngadaltë, me çka karboni del në sipërfaqe në formën e grafitit. Hekuri i papërpunuar i kaltër është i njohur si **gus** dhe përdoret për:

- mbushjen e gypave
- për kanalizim;
- furrat për nxehje etj.

**Mbaje mend:**

**Nga furnaltat fitohen dy lloje hekuri: hekuri i bardhë i papërpunuar dhe hekuri i kaltër i papërpunuar.**

**Nga hekuri i bardhë i përpunuar fitohet çeliku.**

Pyetje:

Prej cilave xehe të hekurit fitohet hekuri?  
Si fitohet hekuri i kaltër i papërpunuar?

Detyra:

Në rrethinën tënde, së bashku me mësimdhënësin në mësimin praktik, vizito shkritore me furnaltë për fitimin e hekurit dhe njohu me procesin për fitimin e hekurit!



## 2.2 Fitimi i çelikut

Sot, pjesa më e madhe e çelikut fitohet nga hekuri i bardhë dhe i vjetër, me shtimin e shtesave të caktuara, në varshmëri nga kualiteti i lëndës së parë të disponueshme.

Ekzistojnë më shumë mënyra për fitimin e çelikut, por më të njohura janë:

- Konvertori i Tomasov-Besemerovit;
- Fura e Simens-Martenovit;
- Fura elektrike.

### 2.2.1 Konvertori i Tomasov-Besemerovit

**Konvertori i Tomasov-Besemerovit** për fitimin e çelikut përdor enë cilindrike-konvertor që në majë ngushtohen në formë të konit (fig. 2.2).






Fig. 2.2 Fitimi i çelikut në konvertorin e Tomasovit

Konvertori është i ndërtuar prej lastrave të trasha të salduara ose farkuara. Fas-hat e konvertorit janë ndërtuar prej materialit rezistues ndaj zjarrit.

### Mënyra e përfitimit të çelikut:

Nëpër hekurin e papërpunuar fryhet gaz i kompresuar që përmban oksigjen. Ai mundëson të digjen të gjitha elementet nga hekuri i papërpunuar, siç janë:

- karboni;
- siliciumi;
- mangani;
- fosfori.

Mënyra e konvertuar për fitimin çelikut është shumë e shpejtë dhe ekonomike, por ka dobësi të vogla. Në vetë procesin nuk vjen deri te lirimi i plotë i fosforit dhe azotit, që e bëjnë çelikun me kualitet më të dobët.

### 2.2.2 Procesi i Simens – Martinovit për përfitimin e çelikut

Përdoren furra të palëvizshme në formë korite të tipit të mbyllur. Në këto furra krahas hekurit të papërpunuar shtohen edhe mbeturinat e hekurit (fig. 2.3) dhe (fig. 2.4).




Fig. 2.3 Procesi i Simens – Martinovit për përfitimin e çelikut



Fig. 2.4 Furra e Simens – Martinovit për përfitimin e çelikut

Në këtë furrë shtohet flaka me gaz dhe ajër, me temperaturë prej 1650°C deri më 1700°C. Në këtë mënyrë përfitohet çelik më i pastërtë se sa prej procesit konvertues. Procesi është më i ngadalshëm, por ka kapacitet më të madh edhe deri më 300 tonë.

### 2.2.3 Fitimi i çelikut në furrat elektrike

**Në „Makstil“, në Shkup, fitimi i çelikut bëhet në fura elektrike (fig. 2.5).**

Ka më shumë lloje të furrave elektrike, por më së shumti përdoren furrat me lak elektrik dhe me induksion. Me këtë proces fitohet çeliku më me kualitet, por edhe më i shtrenjtë për shkak të sasisë së madhe të rrymës elektrike që përdoret (fig. 2.6).




Fig. 2.5 Fitimi i çelikut në furra elektrike




Fig. 2.6 Fitimi i çelikut në hekurinë

**Mbaje mend:**

**Mënyrat më të njohura për fitimin e çelikut janë:**

- **Konvertori i Tomasov-Besemerovit;**
- **Procesi i Simens-Martinovit;**
- **Elektro-procesi.**

**Për fitimin e çelikut sipas procesit të Simens – Martinovit, hekurit të papërpunuar, i shtohen edhe mbeturinat e hekurit.**

**Në „Makstil”, Shkup, fitimi i çelikut bëhet në fura elektrike.**

Pyetje:

Numëroi përparësitë dhe dobësitë e mënyrës së konvertimit për fitimin e çelikut!

Shpjegoje procesin e Tomasov-Besemerovit për fitimin e çelikut!

Numëroi karakteristikat për procesin e Simens-Besemerovit!

Cilat elektro-furra më së shumti përdoren?

Me cilat procese fitohet çeliku më me kualitet?

Cili proces për fitimin e çelikut është më i shtrenjtë dhe pse?

Detyra:

Vizitoje fabrikën për fitimin e çelikut dhe njihu me procesin!

### 3. LLOJET E ÇELIQEVE TË NDËRTIMTARISË

#### 3.1 Llojet e çelikeve të ndërtimtarisë

Sipas përdorimit të çelikut dallojmë:

- çelike konstrukcioni;
- çelike për vegla.

##### 3.1.1 Çeliket e konstrukcionit

Me çelike konstrukcioni nënkuptohet çeliku që përdoret për përpunimin konstrukcioneve të çelikut (fig. 3.1), (fig. 3.2), (fig. 3.3) dhe (fig. 3.4) për:

- ndërtim ndërtesash të larta;
- ndërtim të urave;
- anije ndërtimtarie.



Siloset



Shtyllat e antenave



Ura „Gulden brixh“



Ura hekurudhore

Fig.3.1 Objekte me konstrukcione çeliku





Fig.3.2 Xehet dhe industria për feronikël „Feni” - Kavadar



Fig.3.3 Qendra sportive “Boris Trajkovski” Shkup



Fig.3.4 Shumë katëshe nga konstruksionet e çelikut

**Sipas përbërjes kimike çeliquet ndahen:**

- Çeliquet e karbonit që mund të jenë: ulët të karbonizuar dhe çelique lartë të karbonizuar;
- Çeliquet e leguruar, që mund të jenë: ulët të leguruar dhe lartë të leguruar.

Te çeliquet e karbonit ndikim më të madh në veprimin e tyre ka karboni, kurse te çeliquet e leguruar, krahas karbonit ndikim të madh kanë elementet e leguruarra. (Tabela 3.1)

**Mbaje mend:**

**Në ndërtimtari zbatim më të madh kanë çeliquet ulët të karbonizuar dhe ulët të leguruar.**

**Sipas mënyrës së përfitimit, çeliquet ndahen në:**

- çeliquet e Besemerovit ose Tomasovit;
- çeliquet e Simens – Martinovit;
- elektro-çeliquet.

**Sipas shkallës dhe kualitetit dallojmë:**

- çelik të rëndomtë;
- çelik për konsum të gjerë;
- çelik me kualitet;
- çelik i fisnikëruar.

Tabela 3.1

Elementet kimike	Si	Mn	Cr	Ni	W	Mo	V	Co	Ti	Cu	Al
Përmbajtja në %	0,6	0,8	0,3	0,3	0,1	0,08	0,01	0,1	0,05	0,4	0,1

**3.2 Shenjat e çeliqueve të ndërtimtarisë****Çeliquet shënohen me shenja.**

Të gjitha pjesët gjatë përpunimit të konstrukcionit shënohen me shenja që është dhënë në vizatim. Ajo shënohet me ngjyrë të yndyrshme ose me shtypje në materialin.

Shenja e çelikut e tregon fortësinë e tyre të këputjes dhe përbërjen e tyre kimike. Ajo e përmban numrin e pozicionit dhe numrin e vizatimit.

Ato përbëhen më së shumti prej katër pjesëve:  
 - simbol me shkronja C (Ç) dhe CL (ÇL) (çelik dhe masa);  
 - shenja themelore shënon llojin e çelikut edhe në raport me këtë ekzistojnë dy lloj çeliqesh:

- çelique me veti të vërtetuara mekanike, dhe
- çelique me përbërje kimike të vërtetuar dhe veti mekanike.

### 3.2.1 Çelique me veti të vërtetuara mekanike

Në këtë grup bëjnë pjesë: çeliquet e karbonit dhe veti të dëshmuara mekanike dhe përbërja e dëshmuar pjesërisht ose e pa dëshmuar kimike.

Simboli në vendin e parë është numri „0”, që e shënon përkatësinë e çelikut ndaj grupit me veti të dëshmuara mekanike.

Simboli në vendin e dytë nga shenja themelore shënon fortësinë minimale të këputjes në gjendje të nxehtë të formuar ose normale.

Simboli në vendin e tretë, katërtë, pestë, shënon përkatësinë e çelikut në nëngrupin e caktuar (Tabela 3.2).

Tabela 3.2

Grupi i çelikut	Çeliquet e karbonit me veti të dëshmuara mekanike	
Simboli në vendin e parë	0	
Simboli në vendin e dytë	Simbol	Fortësia e këputjes (Mpa)
	0	Nuk është vërtetuar
	1	Deri 320
	2	Prej 330 deri 350
	3	Prej 360 deri 380
	4	Prej 390 deri 480
	5	Prej 490 deri 580
	6	Prej 590 deri 680
	7	Prej 680 deri 780
	8	Prej 790 deri 880
9	Prej 890 dhe lartë	
Simboli në vendin e tretë, katërtë dhe pestë	Simbol	Nëngrupet e çelikut
	00 deri 44	Pa përmbajtje të vërtetuar të P dhe S
	101 deri 449	Me përmbajtje të vërtetuar maksimale të P dhe S
	45 deri 79 451 deri 799	Me përmbajtje të kufizuar të P S dhe përmbajtje pjesërisht të kufizuar të C, Si, Mn
	0 deri 99 801 deri 999	Me përmbajtje të kufizuar të P S dhe përmbajtje pjesërisht të kufizuar e C, Si, Mn shtojca e elementeve të leguruara



### 3.2.2 Çeliquet me përbërje të vërtetuar kimike dhe veti mekanike

Në këtë grup bëjnë pjesë: çeliquet e karbonit me përbërje kimike të vërtetuar dhe veti mekanike, si dhe çeliquet e leguruara. Simboli në vendin e parë nga shenja themelore e shënon elementin më me ndikim kimik edhe atë:

- për çeliquet e karbonit me përbërje të vërtetuar „1”
- për çeliquet e leguar përdoren simbole të dhëna në Tabelën 3.3 numri themelor 1

Tabela 3.3

Simboli numërues	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Elementi i legurës	C	Si	Mn	Cr	Ni	W	Mo	V	tjetër

Shenjzimi i çeliqueve ndryshon me ndryshimin e standardevë tona.

Përdoren dy lloje të shenjzimit:

**Shenjzimi teknik** – sipas të cilit çeliku e fiton emrin e vet sipas kufirit të zgjatjes.

**Nga çeliquet e karbonizimit** të ulët zbatim më të madh në ndërtimtari kanë çeliquet me shenjat vijuese:

#### shenja teknike

CN 240 B  
CN 240 C  
CN 240 D  
CN 280 C  
CN 280 D

#### shenjë e prodhuse

C 0361  
C 0362  
C 0451  
C 0452  
C 0453

#### Shenja prodhuese

Çeliquet me shenjën prodhuese **C 0361 dhe C 0451** përdoren për konstruksi-  
one të salduara të çelikut.

Çeliquet me shenjën prodhuese **C 0362 dhe C 0452** përdoren për konstruksi-  
one dinamike të ngarkuara me dimensione më të vogla.

Çeliquet me shenjën prodhuese **C 0363 dhe C 0453** përdoren për konstruksi-  
one dinamike të fuqishëm të ngarkuara dhe për elemente të trasha.

Këto çelique i takojnë grupit të çeliqueve me veti të vërtetuara mekanike.

Simboli në vendin e parë është „0”.

Simboli në vendin e dytë na tregon se këto çelique kanë fortësinë e këputjes  
edhe atë, numri „3” prej 360 deri 380 Mpa, numri „4” prej 390 deri 480 Mpa.

Simboli në vendin e tretë dhe katërtë na tregon se këto çelique i takojnë nëngrupit të çeliqueve me përmbajtje të vërtetuar të S dhe P dhe përmbajtje pjesërisht të kufizuar të elementeve themelore kimike C, S dhe Mn.

Për realizimin konstruksioneve të çelikut ose elementeve, zbatim të madh kanë edhe çeliquet me shenjat vijuese:

**shenja teknike**

CN 360 B  
CN 360 C  
CN 360 D

**shenja prodhuese**

C 0561  
C 0561  
C 0561

Te këto çelique fortësia e këputjes sillet në kufijtë prej 490 MPa deri 580 MPa dhe i takojnë grupit të çeliqueve me veti të vërtetuara mekanike.

**Mbaje mend:**

**Shenja e çelikut e tregon fortësinë e tij të këputjes dhe përbërjen e tij kimike.**

**Ekzistojnë dy lloj shenjash: teknike dhe prodhuese.**

Pyetje:

Me çka shënohen çeliquet e ndërtimtarisë?

Definoje çka është shenja!

Numëro çelique me veti të vërtetuara mekanike!

Cilat çelique janë me përbërje të vërtetuar kimike dhe veti mekanike?

Shpjegoi simbolet e shenjës themelore!

Çka tregon shenja e çelikut?

## 4. PROFILET E ÇELIKUT DHE PËRPUNIMI NË PUNËTORI

### 4.1 *Format e prodhimeve të çelikut*

Formimi i formës së profileve të çelikut fitohet në me rrafshues me rrokullisje të ngrohët ose ftohët.

Procedura e rrafshimit fillohet me lëshimin e barmës së çelikut (fig. 4.1) e nxehur deri në temperaturën e nevojshme dhe lëshimi nëpër sistemin e rrafshimit. Me këtë rast, gradualisht zvogëlohet trashësia, kurse rritet gjatësia e prodhimit në varshmëri nga dimensionet dhe format e prodhimit final.

Në raport me temperaturën gjatë së cilës bëhet rrafshimi dallojmë rrafshues të ngrohët dhe ftohët.

Me rrafshim të ftohët barma përpunohet në sllav, kurse pastaj sllavi përpunohet në prodhime të tjera ose gjysmë prodhime, më shpesh lastër (fig. 4.2, fig. 4.3 dhe fig. 4.4).



Fig. 4.1 Prodhimi i barmës



Fig. 4.2 Prodhimi i sllavit



Fig. 4.3 Rrafshimi i lastrës




Fig. 4.4 Prodhimi i profilit me rrafshim të ngrohët

Në rrafshueset e ftohta rrafshimi bëhet në temperaturë të dhomës dhe me këtë rast më shpesh dedikohen për rrafshim: lastra e hollë, teli ose profilet (fig. 4.5).




Fig. 4.5 Rrafshimi i ftohët dhe formësimi i ftohët i profilit

Gjysmë prodhimet e çelikut që fitohen në uzinat për petëzimin e çelikut janë:

- shkopinjtë;
- lastrat;
- tërat bartëse të profiluar.

**Shkopinjtë** paraqesin elemente konstruktive që karakterizohen me diametër relativisht të vogël në raport me gjatësinë e tyre dhe janë të njohur si çelik thupre.

**Lastrat** paraqesin elemente konstruktive me dy dimensione shumë të mëdha në raport me të tretën (trashësia e tyre).

**Profilet** e çelikut janë elemente konstruktive me prerje të ndryshme të tëthorët, të cilat sipas mënyrës së përpunimit ndahen në profile nxehët të rrafshuara dhe të formësuar në të ftohët.

#### 4.2 Shkopinjtë

Në këtë grup bëjnë pjesë:

- hekuri i shtypur;
- çeliku universal;
- këndet L- profilet.

**Hekuri i shtypur** – fitohet me shtypje ndërmjet dy cilindrave paralel, për atë ka dy sipërfaqe të rrafshëta. Prodhohet me trashësi  $d=3-40$  (100 mm), gjerësia  $b=10-150$  mm dhe gjatësi  $L=3-15$  m. Shënohet me  $\neq \mathbf{b, d...L}$  (fig. 4.6).




Fig.4.6 Shtypja e ftohët e hekurit të shtypur

**Çeliku universal** fitohet me rrafshim nëpër sistemin prej katër cilindrash edhe atë, dy horizontal dhe dy vertikal, me çka fitohen katër sipërfaqe të rrafshëta dhe tehe të ashpra (fig, 4.7). karakterizohet me fortësia më të mëdha nga çeliku i petëzuar. Prodohet me trashësi prej 3 mm deri më 40 (100 mm), gjerësia prej 150 deri më 1100 mm dhe gjatësia prej 3 deri më 12 m. Shënohet njësoj si çeliku i petëzuar  $\neq$  **b, d...L**. (fig.4.8).




Fig.4.7 Shtypja e ftohët




Fig.4.8 Ftohët i shtypur

**Çeliku rrethor** prodohet me diametër prej 5 deri më 300 mm. Çeliku rrethor me diametër më pak se F 5 mm quhet tel, kurse prej F 5 deri F 40 armaturë. Çeliku rrethor për diametrat deri F 12 porositet në makara, kurse diametrat më të mëdhenj në copa, në duaj me gjatësi maksimale 12 m. Shenjat në vizatimet për to janë: Prej  $\phi$ **d...L** (fig. 4.9 dhe fig. 4.10).



Fig.4.9 Armatura e lëmuar




Fig.4.10 Armatura me brinjë

**Çeliku katrorë** është me anë prej 5 deri 300 mm. Shenja për të është **(d)** (fig. 4.1).  
**Çeliku gjashtëkëndësh** është me dimensione të rrethit të shkruar prej 5 deri 300 mm. Shenja është **(s)** (fig. 4.11).





Fig.4.1 Forma të ndryshme të gjysmëprodukteve të çelikut në grupin e shkopinjëve

**Profilat këndorë** mund të jenë **rafshgjatë** kur raporti i anëve u është 1:1. Shenja është **L b.b.t...L**. Këndi më i vogël që përdoret në konstruktionet është L 45. 45.5, kurse më i madh L 200. 200 16 për këndet rafshgjatë. (fig 4.12)





Fig. 4.12 Këndi rafshgjatë



**Këndi i gjatësisë** së ndryshme është kënd te i cili anët janë 1:1,5 pse 1:2. Shenjat janë **L b.a.t...L**. Këndi më i madh gjatësisë së ndryshme është me dimensione L100.200.14 (fig.4.13)





Fig. 4.13 Këndi me gjatësi të ndryshme

### 4.3 Lastrat

Lastrat me elemente të tilla gjerësia e të cilave është shumë më e madhe se trashësia e tyre. Ato porositen në formën e **shiritave, tabelave dhe lamelave**. Fitohen me lëshimin e pandërprerë të masës së çelikut nëpër sistemin e cilindrave përdërisa nuk fitohet trashësia e caktuar e shiritit, kanë gjatësi të pakufizuar, gjerësi prej 600 mm dhe më shumë, si dhe gjerësi me prerje të pjerrët më të vogël se 600 mm.

Lastrat pas shtypjes duhet të plotësojnë edhe disa kushte të dhëna me standardet tona, siç janë: **pësjtjellja, rrafshët dhe toleranca për trashësinë**.

Sipas **trashësisë** lastrat mund të jenë:

- **lastra të holla me trashësi më të vogël se 3mm;**
- **lastra të mesme me trashësi prej 3 deri 5mm;**  
(lastrat e holla dhe mesme porositen në lëshim) (fig. 4.14)
- **lastrat e trasha (vrazhda) me trashësi mbi 5mm.**

(trashësia e lastrave porositet si pllaka me dimensione 2100mm dhe gjatësi prej 12m) (fig. 4.15)



Fig 4.14 Lëshshet  
(lastrat e holla dhe të mesme)




Fig. 4.15 Pllakat (lastrat e trasha)

Sipas formës lastrat mund të jenë:

- **të rrafshëta;**
- **trapez;**
- **panel.**

**Lastrat e rrafshëta** kanë zbatim të madh në përpunimin e një konstrukcioni të çelikut, qoftë të jetë në ndërtimtari, makineri, industri etj. sot me teknologjinë e përsosur të përpunimit të trave bartës të lastrave, zbatimi i këtyre lastrave është me rëndësi të madhe në ndërtimtari. Të njëjtat përpunohen me gjerësi prej 200 mm, trashësi 20 mm dhe gjatësi prej 6 deri më 12 m në varshmëri nga trashësia dhe gjerësia.

**Lastrat e valëzuara (trapeze)** kohës fundit kanë zbatim të gjerë në ndërtimtari. Trashësia e lastrës arrin prej 0,6 deri më 1,5 mm. Këto lastra prodhohen prej teneqeve të rrafshëta të holla kur të njëjtat do të lëshohen të kalojnë nëpër cilindra të konstruktuar specialë, në gjendje të ftohët (fig. 4.16). Kohës së fundit lastrat e këtilla plastifikohet dhe më së shumti përdoren për konstruktionet e kulmeve (fig. 4.17).



Fig. 4.16 Përpunimi i lastrave trapez




Fig. 4.17 Format e ndryshme të lastrave trapez



Lastrat trapez kombinohen më shpesh me dy lastra dhe izolim termik nga les-hi i qelqit ose gurit – tervoll dhe fitohen dhe fitohen të ashtuquajtur **panel-sandviç**. Përpunohen **panel-sandvuç** mbulesa (fig. 4.18) dhe **panel-sandviç të fasadave** (fig. 4.19). Këto sandviç – panela karakterizohen me termo izolim të shkëlqyeshëm, janë të lehta, thjeshta dhe shpejtë montohen.




Fig.4.18 Sandviç-panela mbuluese




Fig. 4.19 Sandviç – panela fasade

Sipas përpunimit të sipërfaqes lastrat mundet të jenë:

- **rrafshëta (lëmuara);**
- **brinor;**
- **lythëta;**
- **perforuara ose shpuara.**

Lastrat brinore dhe lythëta kanë zbatim të gjerë në objektet industriale për mbulimin e kanaleve, rrugicave, shkallëve, platformave etj. Kjo është rezultat i bartshmërisë së tyre të mirë, por edhe sipërfaqes së pa rrëshqitshme që fitohet prej brinjëve, respektivisht lythat në sipërfaqen e tyre. Janë me më shumë lara të brinjëve (fig. 4.20). Përpunohen me trashësi prej 2,5mm deri më 10 mm paketim prej 1 deri 2,5mm.




Fig. 4.20 Lastra brinore dhe lythëta

**Lastrat e perforuara** përdoren për përpunimin e kanaleve ventilues, për mbylljen ose mbrojtjen të pjesëve ku domosdo të qarkulloi ajri, elemente dekorues etj. Përpunohen me preforim të lastrave të lëmuara në presa. Janë me gjeometri të ndryshme në vrimat (rrethore, katrore, elipsoide etj) (fig. 4.21).




Fig.4.21 Lastrat e perforuara

#### 4.4 Profilet e çelikut

Profilet e çelikut janë elemente konstruktive që gjejnë zbatim të gjerë në konstruktionet e çelikut. Sipas mënyrës së përpunimit mundet të jenë:

- profilet e ngrohta të shtypura, dhe
- profilet e ftohta të shtypura.

##### 4.4.1 Profilet e ngrohta të shtypura

**Profilet e ngrohta** të shtypura përpunohen derisa çeliku është në gjendje të ngrohët duke kaluar cilindrat e konstruktuar special. Më të zbatuara nga profilet çelike është ai **normal dhe profili** i cili e mori emrin sipas pamjes së tij.

Për herë të parë e solli inxhinieri francez **Zores, në vitin 1845**. karakterizohet me **dy boshte** simetrike dhe përbëhet prej **një brinje dhe dy thika** që përpunohen nën pjerrtësi prej 14% që është kushtëzuar nga mënyra e rrafshimit. Përdoren si tra bartës, përkatësisht element i trarit. Prodohet me  **$h=80-1000\text{mm}$**  kurse në disa vende edhe deri më 1400 mm. (fig. 4.22)




Fig.4.22 Rrafshimi i profilin I

Shenja e vizatimit është **I(h)** (fig.4.23)




Fig.4.23 Rrafshim i ngrohët I(h)

Si variant e I (parë) – profili është i **profilit pajnerovit**, shenja e të cilit është **IP h...L**. Edhe ky profil i ka dy boshte në simetri dhe gërshërë të gjerë në raport me profilin I që mundëson fortësi më të madhe nëpër të dy boshtet. Për atë më shumë përdoret për përpunimin e simboleve.

Sot në Evropë dhe botë prodhohen tipe më të ndryshme të trarëve bartës I me gërshërë të gjerë, siç janë NEA, NEV dhe NEM dhe tjera (fig. 4.24).




Fig. 4.24 Tipe të ndryshme të profileve I me gërshërë të gjerë

Krahas këtyre profileve në praktik zbatohet edhe tra bartëse [ a. q. **profili kanal** dhe i njëjti prodhohet me lartësi prej 65 deri më 300 mm ose 400 mm.

Karakterizohet me një bosht të simetrisë dhe përbëhet prej dy gërshërëve dhe një brinje me pjerrtësi të njëanshme prej 8% ose 5% që varet prej lartësisë së profilit.

Ky profil has zbatim të gjerë për përpunimin e **shtyllave, kurse mundet të përdoret edhe si element ndërtimor.**

Më shpesh zbatohen si një ose në kombinim me **një ose më shumë profile**. Shenja e profilit është [ **h...L** (fig. 4.25).




Fig.4.25 Profili i ngrohët i rrafshuar

#### 4.4.2 Profili i formësuar në të ftohët

**Profilet e formësuar në ftohët** përpunohen me dredhjen e lastrës në gjendje të ftohët. Lastra paraprakisht kalon nëpër sistemin e cilindrave ku bëhet rrafshimi i dhe rregullimi i tij deri te trashësia e nevojshme, kurse pastaj dredhet në formën e dëshiruar.

Dredhja bëhet gradualisht, përmes **6-12 cilindrave dhe shtypësve**.

Sipas **formës** këto profile mund të jenë me:

- prerje të hapur;
- prerje të mbyllur.

Trashësia e mureve arrin prej 3 deri më 16 mm.

Formësimi i ftohët i profileve hasin në zbatim të gjerë pothuaj se në të gjitha fushat në industri. Për shkak të formave të volitshme të prerjes kanë karakteristika të mira gjeometrike, janë të lehtë dhe përdoren për përpunimin e **konstrukcioneve të kulmeve, shtyllave etj.** (fig. 4.26)

Me përsosjen e teknologjisë së tyre, këto profile gjejnë zbatim gjithnjë e më të madh në përpunimin e grilave hapësinore me të cilat arrihet mbulimi i hapësirave më të mëdha.

Nga profilet e këtilla realizohen konstruktionet në aeroportin e Shkupit.




Fig. 4.26 Format e ndryshme të profileve në formësimet e ftohta



#### 4.5 Përpunimi i pjesëve të çelikut në punëtori

Çdo konstruksion çeliku përbëhet prej pjesëve që paraprakisht përpunohen në punëtori. Në kantierit e ndërtimit ato vetëm montohen me konstruksionin me ndihmën e vidave ose saldimit. Konstruksionet e çelikut kryhen në punëtorit, kurse jo në kantierët e ndërtimit për shkak të kërkesave gjithnjë e më të mëdha që kanë të bëjnë me kualitetin dhe fuqinë bartëse d.m.th. **temperaturë përkatëse, lagështi, mbrojtje nga ndikimet atmosferike, kushtet e mira për punë në punëtorit dhe mundësia e kontrollimit të kualitetit.**

Elementi më i shpeshtë që përpunohet në punëtori ka disa elemente përbërëse. Çdo pjesë dhe çdo operacion në to kryhet veç e veç. Për këtë shkak, është e nevojshme të dihet mënyra e realizimit të operacionit përkatës dhe rendi i realizimeve. Kjo definohet me projektin, respektivisht vizatimet në punëtorit për konstruktim.

##### 4.5.1 Drejtimi i lastrave dhe profileve

Gjatë përpunimit (prodhimeve) të lastrave dhe profileve mund të vijë deri te lakimi i tyre. Për atë, para se të ndërtohen në konstruksion ato duhet të drejtohen me lëshimin nëpër sistemin e cilindrave.

Distanca ndërmjet cilindrave rregullohet ashtu që lastrat më së shumti lako-hen që të lirohen prej shtrirjeve të tjera gjatë rrokullisjes, kurse pastaj drejtohen.

Profilet drejtohen në shtypës të veçantë pa nxehtësi nëse janë pak të lakuara ose me nxehtësi deri më 600°C, nëse janë më shumë të lakuar.

##### 4.5.2 Lakimi i elementeve të çelikut

Forme e nevojshme e **lastrës** fitohet me lakimin e tyre me ndihmën e **shtypësve dhe veglave**.

Forma rrethore më së shpeshti fitohet me ndihmën e **cilindrave** të cilët ashtu janë të radhitur, dhe lakimin e bëjnë gjatë lëvizjes së tyre rrotulluese (fig. 4.27).

Lakimi i këndeve dhe profileve bëhet me ndihmën e **makinave të veçanta ose prapë në shtypëse për lakimin e profileve deri te forma e dëshiruar**.



Fig. 4.27 Profilimi i lastrave

### 4.5.3 Shënimi

Shënimi është përcjellja e dimensioneve të elementeve nga vizatimi te materiali prej të cilit do të punohen elementet.

Në varshmëri prej formës dhe llojit të elementit dhe pajisjeve me të cilat disponohet si dhe aftësisë profesionale të punëtorit, shënimi mundet të bëhet në më shumë mënyra, edhe atë:

**Shënimi me ndihmën e shablloneve** – për elemente më të komplikuar dhe elementeve që përpunohen në seri më të madhe. Së pari, në lastrën e hollë përpunohet shabllon në P 1:1 me formën e njëjtë si edhe elementi, kurse pastaj me ndihmën e tij bëhet bartja te materiali.

**Shënimi direkt** – qëndron në atë që punëtori së pari e lexon vizatimin dhe direkt i bartë dimensionet në materialin prej të cilit duhet të ndërtohet elementi. Gjatësia e profilit bartet dhe përcaktohet me metër çeliku. Shënimi bëhet me gjilpërë çeliku maja e të cilit është prej **çelikut të fortë**. Shënimi i vrimave për vidat dhe gozhdët së pari bëhet me gjilpërë çeliku, kurse pastaj në mënyrë shtuese shënohet me shilec (kurner) që len gjurmë të thella dhe kështu fiksohet vendi për shpim. Vijat rrethore shënohen me **gjashtëkëndësh me gjilpërë çeliku**, kurse **vrimat e para me këndmatës ose vickël**.

**Shënimi me ndihmën e fotoqelive** – është njëra prej **procedurave gjysmë automatike** për përpunimin e elementeve. Forma e elementit paraprakisht vizatohet në letër me tush (hamer), pastaj vizatimi vendoset në makinë ku fotoqelive e përcjell vijën e zezë të hamerit, kurse vegla bënë prerjen e lastrës. Kjo mënyrë është e mirë për **ndërmarrjet e përbëra dhe sasisë më të mëdha**.

**Shënimi i programuar** – kjo mënyrë shënimi has zbatim gjatë hapjes së vrimave për vida dhe gozhdë, prerjen e profilit dhe gypave dhe për operacione të tjera. Ajo qëndron në kompjuterët paraprak të programuar. Makina me të cilën kryhet ndonjë operacion fiton komandë automatike për lëvizje dhe kryerjen e operacionit.

### 4.5.4 Prerja e lastrave

Varësisht prej elementit që pritet, ekzistojnë më shumë makina dhe vegla, d.m.th. mënyra me të cilat bëhet prerja edhe atë:

a) **prerja me gërshërë** – zbatohet për prerjen e lastrave me trashësi deri 15 mm dhe kënde më të vogla (fig.4.28);



Fig. 4.28 Gërshërë prerjen e lastrave të holla

b) **prerja me gërshërë shtypje** – zbatohet për prerjen e lastrave më të trasha me trashësi (fig.4.29);




Fig.4.29 Gërshërë me shtypje

c) **prerja me ndihmën e sharës** – kjo prerje jep tehe me kualitet, kure realizohet me shtrëngimin paraprak të elementit në bazë speciale, ndërsa prerja realizohet me lëvizjen e lehtë të sharrave të fuqishme. Sot për prerjen e elementeve të çelikut gjithnjë e më shumë zbatohen shara me sharë rrotulluese dhe dhëmbëzime të ndryshme, për prerjen e tipeve të ndryshme (fig. 4.30);



Fig. 4.30 Shara elektrike për prerjen e elemente të çelikut

ç) **prerja me gaz** – kjo mënyrë e prerjes është më e përhapura sepse mund të përdoret për prerjen e të gjitha pjesëve të çelikut pavarësisht prej trashësisë ose pozitës së elementit.

Kjo mënyrë nuk kërkon kushte të posaçme për punë dhe pajisje të komplikuar, ashtu që mund të realizohet edhe në punëtori edhe në terren.

Esenca e prerjes me gaz qëndron në djegien e hekurit në reaktiv me oksigjenin. Ai nxehet në temperaturë prej 1000 deri 1400 shkallë. Nxehja realizohet me djegien e gazit që kalon nëpër një gjilpërë, kurse nëpër tjetrën rrymon oksigjeni nën presion në reaktivin e të cilit çeliku digjet, hedh zgjurë dhe zhvillon temperaturë të lartë.



Prerja me gaz mund të realizohet nëpër më shumë mënyra, edhe atë:

- preje me dorë e profilit, lastra me gjatësi të vogël dhe lastra me formë jo të rregullt (fig. 4.31);



Fig. 4.31 Prerja me gaz –me dorë

- me makinë automatike për prerjen e lastrave me gjatësi më të madhe si dhe në numër më të madh;

- me makinë shtatore për prerjen e lastrave me formë më të ndërlikuar. Ajo është makinë ku pjesa e sipërme është me ujë ose fotoqeli ose me programim (fig. 4.32).




Fig. 4.32 Prerja e lastrave në mënyrë të programuar


#### 4.5.5 Përpunimi i teheve

Gjatë prerjes së elementeve me gërshërë më shpesh vjen deri te shtypja dhe shtrëngimi i materialit në një anë. Ai material duhet të largohet dhe më shpesh tehu i tillë përpunohet me pllakë grihëse. Te lastrat e shkurtra tehet mund të përpunohen me grihë, me çekan pneumatik me dorë ose pllakë grihëse, kurse te tehet më të gjata përpunimi bëhet me zdrukth.

#### 4.6 Përpunimi i vrimave me gozha dhe vidha

Vrimat për pika dhe vidha mund të realizohen me **depërtim** dhe me **shpim**.

**Depërtimi** bëhet me makinë speciale nën presion. Gjatë depërtimit vjen deri te dëmtimi lokal i materialit. Te lastrat e holla dh këndet vrimat e fituara kështu e plotësojnë kualitetin, kurse te lastrat e trasha më parë depërtohet vrimë më e vogël nga e nevojshmja, kurse pastaj me shpimin shtesë hapet vrima e kërkuar.



Me **shpim** fitohen vrimave kualitet të mirë pa marrë parasysh trashësinë e lastrës. Hapja fitohet me ndihmën shpuesve me dorë dhe statik. Shpimi mundet të kryhet për çdo birë veç e veç, ose për më shpejtë më shumë lastra shpohen në paket. Për shpimin e numrit më të madh të vrimave dhe birave me diametër të caktuar përdoren shalona të përpunuar posaçëm.

Fabrikat mirë të pajisura për përpunimin e elementeve të çelikut kanë biruese të mëdha automatike. Ato përbëhen prej sistemit birues horizontal dhe vertikal. Biriimi bëhet pa nënvizimin paraprak për përmes programimit (fig. 4.33).




Fig. 4.33 Hapja e vrimave me shpues

#### 4.7 Përpunimi i elementeve në punëtori

Meqenëse përpunimi i elementeve në punëtori është më me kualitet se në kantier ndërtimi, të gjitha operacionet përpunohen në uzinë.

Në një element duhet të bëhen më shumë operacione para se të bëhet montimi dhe për atë ai element prej një vendi te tjetri bartet me ndihmën e vinçave.

Bashkimi i elementeve dhe montimi i tyre bëhet gradualisht me fitimin e elementeve më të imta, kurse gjatë kësaj duhet të mbahet llogari për pozitën e tyre. Montimi i elementeve dhe rendi i punëve varet prej llojit të elementit konstruktues.

#### 4.7.1 Nënvizimi i elementeve

Të gjitha pjesët gjatë përpunimit të konstrukcioneve nënvizohen me shenja që janë dhënë në vizatim. Ajo bëhet ose me ngjyrë të yndyrshme ose me shtypjen në materialin.

Shenjë e përmban numrin e pozitën e dhe numrin e vizatimit. Pas përputhjes së elementit konstruktiv ai fiton shenjë të posaçme që është dhënë në skemën për montimin e konstruktionit. Mbi bazën e asaj shenje elementi njihet gjatë montimit.

#### 4.8 Mbrojtja e konstrukcioneve të çelikut prej korrozionit

Mbrojtja mund të bëhet në më shumë mënyra, edhe atë:

##### a) Masat konstruktive për mbrojtje

Elementet konstruktive duhet formësohen ashtu që do të pengohet mbledhja e pluhurit dhe papastërtive të tjera dhe do të pengohet qëndrimi i lagështisë në thellësitë e proceseve e thellësive te proceset e sëndukëve. Duhet të mbyllen skajet që të mos prek lagështia dhe të mos ketë qarkullim të ajrit. Te shtyllat e jashtme shputa e bazës duhet të ngritët 20 cm nga tereni dhe të formohet ashtu që nuk do të qëndroi lagështia (fig. 4.34).




Fig. 4.34 Shtylla e jashtme e çelikut

Nëse në konstruktionin e çelikut vendoset metal tjetër, shembull aluminium, është e nevojshme ndërmjet tyre të vendoset izolim. Kjo mbrojtje vendoset për atë se gjatë kontakti direkt të çelikut me metal tjetër vjen deri te reaksioni kimik, me ç'rast zhvillohet procesi oksidimit të çelikut.




Fig. 4.35 Vendorsja e materialit izolues ndërmjet çelikut dhe metalit tjetër

Masa tjetër konstruktive është vendosja e elementit në pozitë që nuk mundëson ndalimin e ujit dhe lagështisë dhe kontaktin e elementeve konstruktive sipërfaqet e të cilave janë të qasshme për vendosjen e lyerjeve (fig. 4.36).



Fig. 4.36 Vendosja e elementeve në konstrukcione

b) **Lyerje mbrojtëse** – më shpesh zbatohen për mbrojtje nga korrozioni.

Qëllimi i kësaj mbrojtje është të pengohet kontakti i çelikut me lagështinë dhe ajrin. Që të bëhet lyerja mbrojtëse më së pari duhet të përgatitet konstrukcioni i çelikut d.m.th. të largohet yndyrshmëria, pa pastërtia, pjesë prej saldimit dhe ndryshku ekzistues.

**Yndyrat** largohen me leckë ose furçe të lagura në tretje për pastrimin e yndyrave.

**Pastrimi i sipërfaqes e përfshirë me korrozion (ndryshk)** mund të bëhet me dorë ose me makine me furçë çeliku (fig. 4.37), pastrim me flakërim, me nxehje deri më 150 oC, pastrim me zhytjen e elementeve të vogla në tretje kimike, në të cilat largohet vetëm shtresa e përfshirë me ndryshk dhe pastrimi me rërishte.




Fig. 4.37 Pastrimi i sipërfaqes me korrozion (ndryshk)

**Rërishtja** është mënyra më e shpeshtë për pastrimin e konstrukcioneve të çelikut. Qëndron në pastrimin e sipërfaqeve të çelikut me çurg abrazivi me presion të lartë.

**Abrazivi** përbëhet prej kokrrave të çelikut me madhësi prej 0,5 deri 1,2 mm, ose rëra e kuarcit prej 0,5 deri 2,5 mm, me goditje të sipërfaqes së çelikut në këndin e caktuar. Kokrrat e nxjerrin ndryshkun dhe pa pastërtinë e (fig. 4.38) dhe (fig. 4.39). Pas rërezimit të sipërfaqes së çelikut, sipërfaqja pastrohet prej pluhurit, pre pastrohet prej pluhurit dhe lyhet me lyrje themelore. Lyerja e parë vendoset menjëherë dhe ka qëndrueshmëri prej 6 muajsh, kurse lyerja e dytë bëhet pas përpunimit të konstrukcionit, kurse para vendosjes së shtresës mbrojtëse.






Fig. 4.38 Abrazivi

Fig. 4.39 Rërësimi i  
konstruksiioneve të çelikut

**Mbrojtja e suvatimit** ka për detyrë ta mbrojë lyerjen themelore. Lyerja bëhet në sipërfaqen krejtësisht të pastërtë dhe thatë dhe në temperaturë jo më të ulët se 5°C. Suvatimet mbrojtëse bëhen në dy mënyra, edhe atë:

- me **brushë dore** ose cilindër për sipërfaqe më të vogla dhe vende të paarritshme (fig. 4.40);



Fig. 4.40 Lyerja me dorë e ngjyrës së yndyrshme

- me **stërpikjen e ngjyrës** me pistoletë nën presion, për sipërfaqe më të mëdha (fig. 4.41).

Trashësia e përgjithshme e lyerjes varet nga agresiviteti i ambientit.

Fig.4.41 Stërpikja e ngjyrës  
me pistoletë nën presion

c) **Zinkim i ngrohët** - është mënyrë e mbrojtjes me zhytjen e elementeve të çelikut në vaskë me zink të shkrirë (fig. 4.42).

Përdoret për mbrojtjen e konstrukcioneve në mjedise industriale detare shumë agresive.




Fig.4.42 Procesi i zinkimit të ngrohët

ç) **Metalizimi** - nënkuptohet lyerje me metal të shkrirë, rezistente ndaj korrozionit në sipërfaqen e çelikut më parë të përgatitur. Për metalizim përdoret zinku, alumini, plumbi etj.

e) **Legurimi** i çelikut bëhet që në procesin e prodhimit me shtimin e metalit që i përmirëson karakteristikat e çelikut. Elemente të legurës janë: kromi, nikeli, bakri, mangani etj (fig. 4.43).




Fig. 4.43 Çeliqe të leguar

## Mbaje mend!

1. Formimi i formës të profileve të çelikut fitohet me **rrafshimin e ngrohtë dhe ftohtë**.

2. Në raport me temperaturën gjatë së cilës bëhet rrafshimi dallojmë rrafshim **të ngrohët dhe ftohtë**.

3. **Gjysmë prodhimet** e çelikut që fitohen nga rrafshuesja janë:

- shkopinjte;
- lastrat;
- tratë e profiluar.

4. **Në grupin e shkopinjve bëjnë pjesë:**

- çeliku i pllakëzuar shënohet me  $\neq$  **b, d...L**
- çeliku universal shënohet sikurse çeliku i pllakëzuar  $\neq$  **b, d...L**.
- këndet L- profilet shënohen me **L b.h.t...L**

5. **Lastrat** janë elemente të tilla gjerësia dhe gjatësia e të cilave është shumë më e madhe se trashësia e tyre.

6. Sipas **trashësisë** lastrat mund të jenë:

- lastra të holla me trashësi më të vogël se 3 mm;
- lastra të mesme me trashësi prej 3 deri 5 mm;
- lastra të trasha (vrazhda) me trashësi mbi 5 mm.

7. Sipas **formës** lastrat mund të jenë:

- të rrafshëta;
- të valëzuara.

8. Sipas **përpunimit** të sipërfaqes lastrat mund të jenë:

- rrasëta (lëmuara);
- brinjor;
- me lytha;
- të perforuara ose të shpuara.

9. **Profilet e çelikut** janë elemente konstruktive që hasin zbatim të gjerë në konstruktionet e çelikut.

10. Sipas mënyrës **së përpunimit** mund të jenë:

- profile ngrohët të rrafshuara;
- profile ftohët të rrafshuara.

11. **Profilet ngrohët të rrafshuara** përpunohen derisa çeliku është në gjendje të ngrohët duke u rrafshuar nëpër cilindrat special të konstruktuar.



12. Më i përdoruri prej profileve të çelikut është **profili normal**. Shenja në vizatim është **I(h)**.
13. **Profili ftohët i formësuar** përpunohet me lakim të lastrës në gjendje të ftohët.
14. Sipas **formës** këto profile mundet të jenë me:
- prerje të hapur;
  - prerje të mbyllur.
15. Forma e **nevojshme e lastrës** fitohet me lakimin e saj me ndihmën e shtypësve dhe veglave.
16. **Nënvizimi është përcjellja** e dimensioneve të elementeve nga vizatimi te materiali prej të cilit do të përpunohet elementi.
17. **Nënvizimi bëhet me:**
- ndihmën e shablloneve;
  - shënimi direkt;
  - me ndihmën e fotoqelive;
  - nënvizim i programuar.
18. **Prerja e lastrave dhe profileve.** Në varshmëri prej elementit që pritet dallojmë:
- prerja me gërshërë;
  - prerja me ndihmën e sharës;
  - prerje me gaz.
19. **Vrimat për gozhda dhe vidha** mund të bëhen me depërtim dhe shpim.
20. **Mbrojtja e konstrukcioneve të çelikut nga korrozioni bëhet në më shumë mënyra:**
- masat konstruktive për mbrojtje;
  - suvatimet mbrojtëse;
  - zinkim i nxehtë;
  - metalizimi;
  - legurimi.

**PYETJE:**

1. Formimi i formës së profileve të çelikut fitohet me rrafshim, që sipas temperaturës gjatë së cilës zhvillohet e njëjta, mundet të jetë:

a)..... rrafshim;

b) .....rrafshim.

2. Cilat gjysmë prodhime të çelikut fitohen me rrokullisje?

3. Në grupin e shkopinjve bëjnë pjesë:

- çeliku i shtypur - nënvizohet me .....

- çeliku universal - shënohet me .....

- profilet këndore L – shënohet me .....

4. Elemente gjerësia dhe gjatësia e të cilave është shumë më e madhe nga trashësia e tyre janë të njohura si .....

5. Çfarë lastrash dallojmë sipas trashësisë së tyre?

6. Çfarë lastrash dallojmë sipas formës?

7. Çfarë lastrash dallojmë sipas sipërfaqes përpunuese?

8. Cilat elemente konstruktive gjejnë zbatim më të madh në konstruktionet e çelikut?

9. Sipas mënyrës së përpunimit profilet e çelikut mund të jenë:

a).....

b) .....

10. Cila është forma e profileve të çelikut më e zbatuara në konstruktionet e çelikut dhe si shënohet?

11. Çfarë mund të jenë profilet ftohët të formësuara sipas formës?

12. Numëroi 3 mënyra të nënvizimit të lastrës dhe profileve!

13. Numëroi tri mënyra të prerjes të lastrave dhe profileve!

14. Cilat masa për mbrojtje nga korrozioni i njeh?

15. Përshkruaje ecurinë për mbrojtje nga korrozioni me lyster!

16. Përshkruaje procedurën për mbrojtje nga korrozioni me zinkimin e ngrohët!

17. Cilat masa konstruktive për mbrojtje nga korrozioni i din?

## 5. MJETET PËR LIDHJE (NGJITËSE) NË KONSTRUKSIONET E ÇELIKUT

Prodhimet nga rrokullisëset: shkopinjtë, lastrat, dhe tratë e profiluar, montohen në punëtori në elemente për konstruksione me ndihmën e mjeteve lidhëse (ngjitëse). Nevoja e paraqitjes të mjeteve për lidhje del kryesisht prej tri shkaqesh, edhe atë:

- për shkak të prodhimeve të gjatësive të kufizuara të gjysmë prodhimeve nga uzinat e ngjeshjes së metalit;
- për shkak të mundësive të kufizuara transportuese;
- për shkak të mundësive të kufizuara për montim.

Mbishtimi dhe ngjitja e elementeve konstruktuese bëhet me mjetet vijuese ngjitëse: **farkimet, vidhat dhe ngjitjet e salduara.**

### 5.1 Gozhdimet

Gozhdimet, si mjete ngjitëse, kanë filluar të përdoren prej vitit 1832. Sot ato shumë rrallë përdoren, përveç gjatë renovimit të konstruksioneve të vjetra të bëra e gozhda (fig. 5.1). Ato janë mjete shumë të sigurta për ngjitje të elementeve në një konstruksion çeliku.



Fig. 5.1 Zëvendësimi i gozhdove të konstruksionet e bëra me gozhdime



Gozhda kështu e **prodhuar** nga shtypësi e ka një kokë me qafë dhe trup, përderisa vetë mbërthimi në konstruksi-on e fiton formën e tij përfundimtare.

Gozhdimet përpunohen nëpër-mjet makinave në presione speciale nga çeliku i rrumbullakët me kualitet Ç3 340 dhe Ç3 440.

Gozhda e papërpunuar, e pa ngji-tur domosdo të plotësojë kritere të cak-tuara, të dhëna në standardet e vendit

në të cilin prodhohet. Ato më shpesh janë:

- të ketë sipërfaqe të rrafshët me tehe qartë të shprehura;
- pa plasaritje;
- të mos ketë gjurmë nga kallëpi;
- të mos ketë ndryshkje ose të djegura etj.

Gozhdimet sipas diametrit, gjatësisë dhe kualitetit **paketohe**n në nga 5, 10, 25, 100, 500 dhe 1000 copa. Në paket patjetër të ketë figurë të gozhdës, të jetë i shënuar prodhuesi, data e prodhimit, standardi sipas së cilit është prodhuar dhe numri i gjozhdave në paketim. Për marrjen e gjozhdave patjetër të posedojnë A test për kualitetin e tyre.

Sipas **formës së kokës** gozhduat mund të jenë:

- a) gozhda me kokë gjysmë rrethi;
- b) gozhda kokë gjysmë të lëshuar;
- c) gozhda me kokë të lëshuar.

Më së shumti përdoren gozhdat me kokë **gjysmë rrethore** (fig.5.2).




Fig.5.2 Gozhda me kokë gjysmë rrethore

Qafa e gozhdave me kokë gjysmë rrethore, me gjatësi prej 50 mm nga tehu i skajit të kokës ka formë konusi, me pjerrtësi të realizimit prej 1%, kurse në vazhdim qafa ka formë cilindrike.

Për shkak të formës konike diametri i gozhdës matet 5 mm nga tehu i kokës.

Gozhdimi i gozhdës mund të bëhet me dorë ose me makinë, me atë që qafa më së pari duhet ta plotësojë vrimën e gozhdës, kurse pastaj formohet koka e poshtme.

Ngjitja me gozhdim bëhet në vrimën më parë të përpunuar në lastrat që bashkohen dhe me vënien e gozhdës e cila është e nxehur në 1000 °C para vendosjes (fig. 5.3).




Fig.5.3 Vendosja e gozhdimeve

**Trashësia** e paketit varet prej elementeve që lidhen me gozhdime me kokë gjysmë rrethore, dhe është:

$$S \leq 4,5 d_1 \quad d_1 - \text{hapja e vrimës për gozhdimet}$$

**Gjatësia** e qafës varet prej mënyrës së farkimit, edhe atë:


- për gozhdimin me makinë  $L = S + (4/3) \cdot d_1$ , dhe
- gozhdimin me dorë  $L = S + (7/4) \cdot d_1$

Ku **L** është gjatësia e gozhdës së papërpunuar, **S** është trashësia e paketit.

Emrin e vetë gozhda e mori sipas vrimës në të cilën vendoset, kështu që ekzistojnë diametrat vijues të standardizuara 11, 14, 17, 20, 23, 26, 29, 32, 35 dhe 38. Për të gjitha gozhdimet sipas diametrit të vrimës ekziston shenja që përdoret në vizatimet teknike.

Gozhdat me kokë **gjysmë të lëshuar** ose të lëshuar kanë zbatim dukshëm më të vogël nga ato me kokë gjysmë rrethore (fig. 5.4).

Këto gozhda kanë zbatim vetëm atje ku koka gjysmë rrethore e gozhdës u pengon disa elementeve nga konstrukcioni.



a) Gozhdet me kokë gjysmë të lëshuar      b) Gozhdet me kokë të lëshuar

Fig. 5.4 Gozhdë me kokë gjysmë të lëshuar dhe të lëshuar

Tabela 5.1 Karakteristikat e gozhdës me kokë gjysmë rrethore

$d$	mm	12	14	16	18	20	22	24	27	30	33
$d_0$	mm	13	15	17	19	20	23	25	28	31	34
$D$	mm	19	22	25	28	32	36	40	43	48	53
$K$	mm	7,5	9	10	11,5	13	14	16	17	19	21
$R$	mm	9,5	11	13	14,5	16,5	18,5	20,5	22	24,5	27
$r$	mm	0,6	0,6	0,8	0,8	1	1	1,2	1,2	1,6	1,6

### 5.1.1 Shenjat e gozhdave

Sipas përpunimit, farkimet mund të jenë: **të punëtorive, montuese dhe gjysmë montuese** (me vrima të shpuara në montim) (fig. 5.5).

Farkimet e punëtorisë komplet përpunohen në punëtori, d.m.th. shpimi dhe farkimi.

Farkimet gjysmë montuese përgatiten në punëtori, d.m.th. shpohen elementet, kurse farkohen në objekt.

Farkimet montuese komplet realizohen në objekt.

Në vizatim farkimet shënohen me simbole që i definojnë sipas formës, diametrit dhe mënyrës së realizimit.

Shenjat themelore për të gjitha farkimet janë me formën e **rrethit**. Me rreth shënohen farkimet me kokë gjysmë rrethi, përderisa në këtë shenjë, shenja shtohet një e katra e rrethit koncentrik për shënimin e farkimit me kokë gjysmë të lëshuar, kurse me shtimin e gjysmës së rrethit koncentrik shënohet farkimi me kokë të lëshuar.

Farkimet gjysmë montuese shenjohen me flamuj të vegjël me një krah, ndërsa ato montuese me dy krahë.



Në vizatimet me përmasa të më të vogla, diametri i simbolit i përgjigjet diametrit të kokës së farkimit, kurse në vizatimet me përmasa më të mëdha shenjat kanë diametër të barabartë me vrimën e farkimit. Më detalishtë janë treguar në tabelën 5.2.

Tabela 5.2


Diametri i kokës së farkimit $d_1$ , mm		14	17	20	23	26	29	32	35	36
Diametri i farkimit të papërpunuar $d$ mm		13	16	19	22	25	28	31	34	37
Diametri i çelikut rrethor $d_0$ mm		12,7	15,5	18,5	21,5	24,0	27,0	30,0	33,0	36,0
Farkimi me kokë gjysmërrethore	Punëtori									
	Montimi									
	Me vrima në montazhë									
Farkimi me kokë gjysmë të lëshuar	Punëtori									
	Montimi									
	Me vrima në montazhë									
Farkimi me kokë të lëshuar	Punëtori									
	Montimi									
	Me vrima në montazhë									



Fig. 5.5 Lidhja e farkuar e konstruksioneve të çelikut



## 5.2 Vidhat



**Vidhat** si mjete lidhëse paraqiten edhe para se të lajmërohen konstruktionet e çelikut, përkatësisht kur ekzistonin vetëm konstruktionet nga hekuri i dergjur. Me paraqitjen e farkimeve, vidhat për një periudhë ishin nxjerrë prej përdorimit, por sot hasin zbatim të gjerë, sidomos gjatë lidhjeve montuese. Mungesa kryesore e farkimeve është vështirë të montohen ishin eliminuar me paraqitjen e vidhave.



Fig.5.6 Vidhë e zakonshme si mjet lidhës

Sot, vidhat janë mjete lidhëse të pazëvendësueshme për montim te konstruktionet e salduara.

Çdo vidh përbëhet prej kokës, qafës (trupit) me vjaskë, vidë (fig. 5.6) dhe pllakës (shajbna) e vendosur mbi vidhën.

**Koka** e vidhës ka formë të gjashtëkëndëshit të drejtë. **Trupi** i vidhës është me formë cilindrike me gjatësi të caktuar nga koka, ndërsa pjesa përfundimtare **është me vjaskë** (fig. 5.7). Vidha (fig. 5.9) ka gjithashtu formë gjashtëkëndëshe që i përgjigjet kokës së vidës, përderisa **pllaka** ka formën e rumbullakët unazore.



Fig.5.7 Vidat me diametër të ndryshëm

Te çdo vidë dallohet:

- diametri i hapjes (vrimës);
- diametri i qafës;
- diametri i bërthamës.

Diametret e vrimave janë të njëjta sikurse te farkimet. Diametri i zhvidhosjes mund të jetë M 10, M12, M16, M22, M24, M27, M 30 mm (fig.5.8).

Tabela 5.4

Diametër $d_1$ mm	11	13	15	17	19	21	23	25	28	31
Diametër $d$ mm	M10	M12	M14	M16	M18	M20	M22	M24	M27	M30
Shenja										

Sipas shkathtësisë së përpunimit të qafës së zhvidhosjeve ato mund të jenë **të përpunuara** dhe **jo përpunuara**.

Diametri i vidave të përpunuara patjetër t'i përgjigjet diametrit të vrimës me tolerancë më të madhe prej 0,2 mm.

Diametri i vidhave të papërpunuara është më i vogël se diametri i vrimave për 1 mm që e lehtëson montimin e tyre.



Fig. 5.8 Vidat dhe vidhat



Fig. 5.9 Vidha

### 5.3. Shtresat e salduara

Saldimi si mënyrë e lidhjes e dy metaleve daton që nga e kaluara, kur teknologjia e përpunimit të metaleve ishte në nivel primitiv.

**Saldimi paraqet vend të materializuar të lidhjes së dy elementeve në një tërësi.**




Fig.5.10 Saldimi i dy elementeve

#### Terminet themelore gjatë saldimit:




Fig. 5.11 Procesi i saldimit

- **Saldimi** është aftësi e një materiali që të saldohet.
- **Ngjitja** paraqet vendosjen e ndonjë materiali që të plotësohet ndonjë e çarë në elementin e shkaktuar nga proceset teknologjike.

- **Saldimi** paraqet proces të bashkimit të dy materialeve me ndihmën e nxehtësisë ose presionit, me ose pa material shtues.

- **Materiali themelor** është materiali prej të cilit janë përpunuar elementet që ngjiten.

- **Materiali shtuesë** është materiali që shtohet në procesin e saldimit në formë të elektrodës ose telit.

- **Ngjitja e salduar (saldimi)** paraqet vendin e ngjitjes së dy elementeve.

### Forma dhe realizimi i ngjitjeve

Në varshmëri nga vendi dhe pozita e elementit që lidhet dallohen:

- saldimet këndore – kur elementet ndërmjet veti mbyllin ndonjë kënd;
- saldimet ballore – kur elementet qëndrojnë në një rafsh.

Për **ngjitjet e çelikut** në varshmëri prej trashësisë së elementeve që lidhen përpunohen ullaqe, ndërsa gjatë ngjitjeve këndore ullaqu formohet nga pozita e tyre ndërmjet tyre.

Ngjitjet emrin e tyre e marrin sipas pamjes së ullaikut në të cilin realizohen. Si pas kësaj, ka ngjitje "I" V, U, X, K, J, 2U, 1/2V dhe tjera. (fig.5.13) saldime.




Fig. 5.12 Përpunimi i ullaqeve




Fig. 5.13 Ulluqe për ngjitjet - I, V dhe X

Gjatë një saldimit dallojmë: **fytyrën** e saldimit, **materialin** e saldimit dhe **rrënjën** e saldimit (fig. 5.14).





Fig.5.14 Pjesët e ngjitjes

### 5.3.1 Shenjat e ngjitjeve të salduara

Ngjitjet e salduara shënohen me simbole sipas të cilave dallohen për nga lloji, kualiteti dhe dimensionet.

Saldimet ballore (fig. 5.15) dhe (fig. 5.16) shënohen vetëm sipas llojit dhe kualitetit të ngjitjeve, sepse nuk dimensionohen dhe i kanë dimensionet e njëjta sikurse edhe elementet që ngjiten. Siguria e lidhjes është e garantuar vetëm me kontrollimin e këtyre ngjitjeve.

Sipas kualiteti ngjitjet mund të jenë:

- me kualitet **special** kualiteti – S;
- kualiteti **I**, dhe
- kualiteti **II**.

shenjat themelore		shenjat plotësuese	
emri i ngjitjes	shenja	shpjegimi	shenja
i-ngjitja	≡	Rrënja e salduar	○
v-ngjitje	∧	Fytyra e përpunuar ose rrënja e ngjitjes	
v-ngjitje me pllakë nën kore	π	ngjitje e kontinuar këndore	⊣
y-ngjitje	∟	Ve kontinuar këndore e dyfishtë	⊞
χ -ngjitje	×	ngjitje e ndërpre këndore	<sup>a...J</sup> Z <sub>e</sub>
u-ngjitje	∩	Faqja e rrafshët e ngjitjes këndore	⊤
Ngjitje të dyfishta	∪	Faqja konvekse e ngjitje këndore	⊥
1/2V- ngjitje	∨	Fytyra konkave e ngjitje këndore	⊦
κ - ngjitje	κ	ngjitje këndore e ngjitur nëpër të gjithë vëllimin	⊞
j - ngjitje	∩	Kontrollimi radiografik	RK
ngjitje e dyfishtë J	∩	Kontrollimi magnetik	MK
ngjitje këndore	∩	Kontrollimi penetruës	PK
Këndi i ngjitur (i rrafshët)	⊣	Kontrollimi me ultrazë	UK
Këndi i ngjitur dyfish	⊞	Kualiteti special i saldimit	S
		Kualitet primar i ngjitje	I
		Kualitet i rëndomtë i ngjitje	II

Ngjitjet me kualitet **special** domosdo duhet të jenë të barazuara, të mos kenë çarje, pa gabime në fillim dhe fund të ngjitjes. Ana e jashtme duhet të jetë e lëmuar



në drejtim të fuqisë, rrënja duhet mirë të jetë e pastruar dhe ngjitur dhe të bëhet incizimi në tërë gjatësinë e saldimit.




Fig.5.15 Ngjitja këndore

**Saldimet me kualitet I** (të parë) duhet të jenë si ngjitja me kualitet special vetëm që te ato nuk është e thënë të bëhet grihja e anës së jashtme dhe incizimi të jetë 50-100% nga gjatësia e ngjitjes.

**Ngjitjet me kualitet II** (të dytë) sipas dukjes janë sikurse ngjitjet me kualitet I vetëm nuk kërkohet incizimi i tyre.

Krahas këtyre shenjave ekzistojnë edhe shenja që kanë të bëjnë me mënyrën e saldimit, kualitetin e ngjitjes dhe punëve plotësuese për përmirësimin e kualitetit të ngjitjes.




Fig.5.16 Ngjitje këndore horizontale dhe vertikale

### 5.3.2 Realizimi i saldimeve

#### Teknika e saldimeve

Procesi i bashkimit me saldim më së shpeshti realizohet m energji nxehtësie.



Fig.5.17 Saldimi elektrolit

Ekzistojnë më shumë teknika të saldimit, edhe atë:

- teknika **me burime mekanike** për saldim (me presion, me eksplozim, me ultrazë, farkim etj);
- teknika **me burime elektrike** (qark elektrik, rezistues elektrik dhe me burime të tjera elektrotermike të nxehtësisë, si difuzë, induktiv etj);
- teknika **me burime termokimike** (saldim me oksiacetilen, aluminotermia).

**A)** Saldimi **me burime mekanike të nxehtësisë** realizohet me presion të lartë mbi sipërfaqet e kontakti të elementeve që ngjiten dhe quhet ngjitje ma presion, kurse përdoret për materiale me veti të larta plastike siç janë: alumini, bakër, plumb, zing, argjend etj (fig. 5.17)

Mënyrë tjetër e saldimit mekanik është edhe **saldimi me fërkim** që përdoret më së shumti për elemente me prerje të tërthortë rrethore.



Fig.5.18 Veglat për saldim


Ngjitja e elementeve realizohet me fërkim në sipërfaqe të cilat të cilat paraprakisht mirë janë të pastruara, me çka krijohet nxehtësi me çka i zbut elementet në sipërfaqet kontaktuese dhe në momentin e dhënë, nën presion, realizohet ngjitja e tyre.

Saldimi **me ultrazë**, gjithashtu është saldimit me burime mekanike që mbështetet në energjinë e nxehtësisë e prodhuar nga valët e ultrazërit me ciklus të caktuar të përsëritjes, amplitudat dhe fuqia e presionit në momentin e dhënë:

Realizohet me makina speciale ku lëshohen elementet të oscillojnë me frekuencë të zgjedhur dhe amplituda me ç'rast formohet fërkim dhe formohet nxehtësi, metali zbutet dhe në momentin e dhënë nën presion bëhet ngjitja.

**B)** Teknika e saldimit me **burime elektrike** ka zbatim më të gjerë në kohën e sotshme.

Gjatë **saldimit elektrolit** temperatura e lartë e shkrirjes të materialit themelor dhe të shtuar realizohet me vendosjen e qarkut elektrik ndërmjet këtyre dy materialeve.



Rryma njëdrejtimëshe vjen nga rryma e trafo ose gjeneratori (zakonisht tensioni i rrymës është prej **17 deri 40 volt**, dhe fortësisë prej **15 deri më 500 amperëve**) dhe ajo pjesë si qark pozitiv lidhet me materialin themelor. Materiali i dhënë në formë

të elektrodës si pol negativ lidhet me dorëzën. Në kontaktin ndërmjet materialit themelor dhe elektrodës formohet pol elektrik që zhvillon temperaturë të lartë dhe i shkrin të dy materialet. E njëjta pjesë nga elektroda dhe materiali themelor quhet **ngjitje**. Një ngjitje mundet të realizohet me një ose më shumë kapje, varësisht prej dimensionit të ngjitjes.




Elektroda si material i dhënë përbëhet prej bërthamës dhe telit të çelikut me trashësi 2.5-6.0 mm dhe mbështjelljes prej mineraleve dhe substancave kimike të ndryshme.

Saldimi elektrolit mund të bëhet me **dorë** ose **makinë**, në varshmëri nga mënyra e përpunimit të konstruktionit të çelikut.

Gjatë kësaj teknike përdoren mjete punuese sikurse: **transformator, kablllo, dara për masë, dorëza për elektroda, çizme lëkure, dorëza lëkure, veshje lëkure mbrojtëse** për operacione ndihmëse. Disa prej këtyre mjeteve të punës janë paraqitur në figurën (fig. 5.19).



Fig. 5.19 Mjetet e punës për saldim



a. transformatorë  
b. helmetë  
c. maskë  
ç. kablllo  
d. mbajtës i elektrodës

dh. elektroda  
e. element që ngjitet  
ë. masa për ngjitje  
f. dorëza mbrojtëse  
g. shtrëngesë nga kabllot

gj. çekan  
h. brushë e çelikut  
i. kincë

Fig. 5.20 Veglat për saldim

Saldimi elektrolit **me dorë** është më i përhapur në industrinë metalike te ne, për atë tekniku patjetër duhet t'i njohë edhe rreziqet nga ky lloj saldimi, që të mundet të ndërmer masa për mbrojtje gjatë punës.



### 5.3.3 Rreziqet nga saldimit elektrolit

- izolimi i keq i kablllove;
- tensioni i zbrazët prej burimit të rrymës;
- gazrat e dëmshëm;
- pluhuri;
- stërpikja nga masa e shkrirë e nxehët dhe elektroda;
- copat e mprehta gjatë pastrimit të bramcit dhe të tjera.



Fig.5.21 Rreziqet gjatë saldimit  
(rrezatimi dhe xixat nga masa e shkrirë e nxehur)

Këto janë disa prej rreziqeve që dëmshëm ndikojnë në njerëzit dhe mjedisin dhe për të cilat duhet të ndermerren **masa mbrojtëse**.

Në (fig. 5.22) është treguar njëra nga fatkeqësitë deri te të cilat mund të vijë për shkak të kontrollimit të pazgjidhur të kablllove.




Fig. 5.22 Mundësia për fatkeqësi në rastin e izolimit të keq të kallove për saldimit

### 5.3.4 Masat për mbrojtje

Masat më shpesh të përdorura për mbrojtje janë:

- të gjitha pjesët metalike që janë nën tension mirë të kontrollohen dhe mbuloohen me ndonjë izolator;
- zgjedhja e burimit të rrymës elektrike në mjedise të ngushta (rezervuar, industria e anije ndërtimtarisë, oxhaqet, siloset etj), duhet të jetë rrymë njëdrejtimëshe. Gjatë punës në lokale të lagështa patjetër të përdoren dysHEME izoluese dhe shtresa izoluese nën elementet që saldohen;
- kabllot për saldim të kontrollohen dhe izolojnë;
- të mos mbahen me vete sende prej metali, vegla dhe të ngjashme gjatë saldimit;
- mbajtja e helmetës dhe maskës mbrojtëse, si mbrojtje nga rrezet e nxehtësisë që paraqiten gjatë qarkut elektrik dhe janë shumë të dëmshme për syrin;
- ndalohet rruajtja e materieve lehtë të ndezshme në afërsi, për atë se gjatë saldimit stërpikin pjesë të xixave;
- hapësirat ku bëhet saldimi duhet të ajrosen më shpesh.

### 5.3.5. Gabimet në saldim

#### **Mbaje mend:**

**Saldimi është proces i ndërlikuar i cili duhet të realizohet në mënyrë profesionale.**

Gjatë përpunimit të saldimeve mund të lajmërohen gabime, që patjetër të kontrollohen dhe largohen.

Gabimet gjatë saldimit mundet t'i ndajmë në dy grupe, edhe atë: dimensional ose të jashtme dhe gabimet në kompaktësinë ose brendësinë:

#### **Gabimet dimensionale (të jashtme)**

Në këtë grup gabimesh bëjnë pjesë:

- mbushja jo e plotë e ullukut;
- mbushja e tepruar e ullukut;
- kalime të ashpra nga materiali themelor;
- prerje në tehet e saldimeve (djegiet);
- mbushja jo e mjaftueshme e rrënjës së saldimit;
- plasaritjet (për së gjati dhe për së gjëri) etj.

Nga të gjitha gabimet e lartë theksuara në saldimit më të rrezikshme për konstruktionet e çelikut janë plasjet për së gjati, të cilat nëse zbulohen, është e nevojshme menjëherë të largohen.

Gabimet e jashtme (fig. 5.23) zbulohen me kontrollim vizual, me kontrollimin detal të saldimit nga ana e personit të kualifikuar.






Fig. 5.23 Gabimet e jashtme te saldimit

### Gabimet në kompaktësinë (brendshme)

Në këtë grup mundemi t'i numërojmë gabimet vijuese në saldimit (fig. 2.54):

- mëshikëzat e gazta (zgavrat ose vijat);
- përfshirje të ndryshme nga ngjyra ose materiali tjetër;
- penetrim i pamjaftueshëm (vend i pa ngjitur dhe pa salduar);
- plasjet e brendshme (për së gjati dhe për së gjëri).




Fig. 5.24 Gabimet e brendshme në saldime

Karakteristikë për këto gabime është ajo se këto gjenden brenda në saldimit, por janë të dukshme me sy dhe mund të zbulohen me metoda të posaçme (ultra zë, rreze gama, rreze rëntgeni, hulumtime penetruese etj.), për atë janë më të rrezikshme nga gabimet dimensionale.

Këto gabime janë të shkaktuara nga teknologjia e keqe në procesin e saldimit, përkatësisht mos përmbajtjes së rregullave ndaj saldimit.

**Pyetje:**

1. Numëroji mjetet për lidhje të elementeve të konstruksioneve të çelikut!
2. Cilat nga mjetet për lidhje janë më të përdorura në kohën e sotme?
3. Çfarë lloje të farkimeve ekzistojnë?
4. Në cilën mënyrë bëhet farkimi i gozhdimeve?
5. Si shënohen gozhdat me kokë gjysmë të lëshuar (disa shembuj)?
6. Numëroji përparësitë e lidhjes së realizuar me vida?
7. Cilat janë pjesët e një vide të zakonshme?
8. Si shënohen vidhat M16, M22, dhe M27?
9. Çka paraqet saldimi?
10. Si shënohen saldimet?
11. Si ndahen saldimet sipas pozitës së vendit të elementeve që saldohen?
12. Përshkruaj pjesët e saldimit!
13. Cilat janë gabimet më të shpeshta të saldimit?
14. Numëroji disa nga mundësitë për rrezik në procesin e saldimit!
15. Përshkruaje pajisjen për saldim!



## 6. KONSTRUKSIONI DHE LLOGARITJA E LIDHJEVE (SHITESAT)

### 6.1 Llojet e shtesave

Për shkak të gjatësisë të elementeve të çelikut ose pa mundësia për transportin e tyre, paraqitet nevoja për shtesat. Shtesat te elementet e çelikut mund të jenë:

- **parciale, dhe**
- **universale.**

Nëse bëhet shtimi vetëm në elementet e veçanta nga prerja e në tra bartës atëherë kemi **shtesë parciale** që zakonisht lajmërohet për shkak të mos pasjes gjatësi të mjaftueshme ose për shkak të pamundësisë të lakimit të elementit.

Nëse në një prerje ose në afërsi sa ndërkreohen ose shtohen të gjitha elementet e asaj prerje atëherë ajo është **shtesë universale** që i diktojnë kushtet e transportit dhe montimi i konstrukcionit.

Në varshmëri nga vendi prej ku bëhet shtesa, dallohen:

- **shtesat e punëtorive, dhe**
- **shtesat montuese.**

### ***Mënyrat për realizimin e konstrukcioneve të shtesave***

Shtesat konstruktive mund të realizohet në mënyra të ndryshme:

- a) shtesat me saldim, dhe**
- b) si lidhje e skalitur, ose me vida.**

Në të dy rastet shtesa mundet të jetë **ballore** ose me **përputhje**.

Farkimi i shtesës ballore mund të jetë:

- a) njëanshme – shtesa jo simetrike mbuluese, dhe**
- b) dyanshme – shtesë simetrike mbuluese.**

Mbulimi i shtesave duhet të jetë simetrike në raport me elementet themelore që shtohen që t'u iket shtrëngimeve që lajmërohen nga momenti i veprimit ekscentrik të forcave.

**Mbulimi i njëanshëm** jo simetrik është i lejueshëm në rastin kur momente nga ekscentrizmi asgjësohen me reaksionet anësore të pjesëve fqinje.

Në vizatimet vijuese janë paraqitur llojet e përmendura të shtesave.

Lidhja e farkuar:




Fig. 6.1 Njëanshme – jo simetrike dhe dyanshme – shtimi simetrik




Fig. 6.2 Lidhja salduese

## 6.2 Shtimi i lamelave

Gjatë shtimit të lamelave çdoherë përparësi duhet t'u jepet shtesave nga mbulimi i dyanshëm për shkak të mbulimit të forcave.

Nëse lamelat janë me trashësi të ndryshme atëherë me ndihmën e të ashtuquajturave dosar bëhet rrafshimi i dallimeve në trashësi. Me këtë rast është mirë dosari të lëshohet për një rend farkimesh që të arrihet përcjellja më e mirë e forcave dhe të zvogëlohet përdredhja e farkimeve.

Te lidhjet e farkuara shtesat e lamelave është më mirë nëse realizohen me shtesë shkallëzore. Në këtë rast fitohet lidhje më e lehtë dhe më ekonomike.

Sipas kësaj, shtesat e lamelave mund të realizohen në dy mënyra, edhe atë:

a) lamelat ndërpriten në një prerje që dyanshëm mbulohet me nën lidhje me trashësi të njëjtë sikurse edhe lamelat që lidhja bëhet me farkime dy prerjesh.

b) prerja e lamelës zhvendoset, fitohet shtesë e shkallëzuar. Mbulimi është i dyanshëm me nën lidhje me trashësi gjysmë trashësisë së lamelave.

Lidhja bëhet me vida të dyanshëme në mes të dy prerjeve me vida dyprerëse jashtë prerjeve.

Në këtë mënyrë fitohet lidhja më e lehtë dhe më ekonomike me përcjelljen më të mira të forcave.

$$\sigma = \frac{N}{A_{op}} \leq \frac{N}{A_{pod}} \leq \frac{N}{A_{r,z}} \leq \sigma_{doz}$$

Ku është:

$\sigma$  – llogaritur shtrirja (përgjithësisht)

$\sigma_{op} = N/A_{op}$  – shtrëngimi i prerjes themelore

$\sigma_{pod} = N/A_{pod}$  – shtrëngimi i nën lidhjeve

$\sigma_{vs} = N/A_{r,z}$  – shtrëngimi në mjetin lidhës (e farkuare ose vidë)

$\sigma_{doz}$  – shtrëngim i lejuar në varshmëri nga rastet e ngarkimit,

$A_{op}$  – sipërfaqja e prerjes themelore

$A_{pod}$  – sipërfaqet e nën lidhjeve


$A_{r,z}$  – sipërfaqja e reduktuar e farkimeve ose vidave.



Edhe këtu vlen rregulla themelore për dimensionimin: për lidhjet e ngarkuara të shtrëngimeve kujdes duhet pasur në dobësimin e sipërfaqeve, nëpërmjet vrimave të farkimeve ose vidat, përderisa për lidhjet e shtypura punohet me bruto sipërfaqet e elementeve që marrin pjesë në lidhjet.

Përcaktimi i numrit të farkimeve ose vidave edhe këtu varet nga prerje e tyre, a janë një prerëse ose dy prerëse.

### një prerëse



### dy prerëse




Fig. 6.3 Farkimet një prerëse dhe dy prerëse

### 6.3 Lidhjet e realizuara me farkime dhe vida të zakonshme

Procedura për përlogaritjen e këtyre lidhjeve përbëhet prej disa hapave edhe atë:

- dispozicioni i lidhjes;
- zgjedhja dhe dimensionet e nën lidhjeve;
- zgjedhja e diametrit të farkimeve (vidave);
- përcaktimi i numrit të nevojshëm të farkimeve (vidave) në lidhjen;
- renditja dhe llogaritja e farkimeve (vidave) në lidhje, dhe
- detale të lidhjeve.

**Dispozicioni i lidhjes** – paraqet atë çka kërkohet me parashtrimin e detyrës.

**Zgjedhja dhe dimensionet e nën lidhjeve** - bëhet ashtu që, nën lidhja ka gjerësi që është minimum i barabartë me gjerësinë e lamelës nga prerje themelore. Në lidhjet nuk bën të jenë me prerje më të vogël, ose me karakteristika më të vogla gjeometrike nga elementet e prerjes themelore.

Trashësia e nën lidhjeve varet prej llojit të lidhjes, a bëhet fjalë për lidhje të njëanshme të mbuluar (jo simetrike) ose lidhje të dyanshme të mbuluar (simetrike).

**Zgjedhja e diametrit të farkimeve (vidave)** – varet nga trashësia e elementeve që marrin pjesë në lidhje. Në vende të ndryshme të botës ekzistojnë shprehje të ndryshme empirike për përcaktimin e përafërt të diametrit maksimal të farkimeve (vidave) prej të cilave te ne janë miratuar këto në vijim:

$$d_{1\max} = t + 10(\text{mm}) \quad \text{për } t \leq 12\text{mm}$$

$$d_{1\max} = t/2 + 16(\text{mm}) \quad \text{për } t > 12\text{mm}$$

$$d_{1\max} = \sqrt{5 \cdot t} - 0,2(\text{cm})$$

Ku **t** është trashësia e elementit më të hollë që merr pjesë në lidhjen.

**Llogaritje e numrit të nevojshëm të farkimeve (vidave)** bëhet sipas forcave që veprojnë në lidhje.  $t > 12\text{mm}$




Fig. 6.4 Lidhja e bërë me vida

Çdo farkim ose vidë e ka fuqinë bartëse të saj në varshmëri nga diametri dhe materiali i tij nga i cili është i përbërë.


Në varshmëri prej kualitetit të materialit themelor, në mënyrë përkatëse zbatohet edhe tipi i farkimit (vidës).

**Renditja e farkimeve (vidave)** të llogaritura bëhet sipas kritereve të caktuara të dhëna në tabelën 6.1.

Shembull: dimensiononi ndërmjet mjedisëve të vrimave (birave) për farkimet dhe vidat është  **$mIn=3d1$** .

Përshkrimi	Min.	Rastet	Max.
Distanca ndërmjet mjedisëve të vrimave (birave) për farkimet ose vidat  e	3-d <sub>1</sub>	Për farkimet bartëse dhe vidat, farkimet dhe vidat në thuprat e shtypura ashpërsimi për lastrën vertikale (brinjore) konstruktive	8-d, ose 15-t
		Për farkime konstruktive ose për vida në thupra të shtrënguara, për vida të brinjëve dhe gërhërë gjatë tra bartëse të lastrave jashtë nga lidhja edhe më dobët farkimet e ngarkuara dhe vidat	12-d, ose 25-t
Distanca ndërmjet meseve të vrimave τθ për farkime ose vida të fundit të elementit në drejtim të forcës  e <sub>2</sub>	2-d <sub>1</sub>	Kur tehu β i ashpërsuar përkatësisht i lakuar për tra bartës të profiluar, kënde etj.)	3-d, ose 9-t
		Në raste të tjera	3d, ose 6-t
Distanca ndërmjet meseve të vrimave për farkime ose vida nga fundi i elementeve tërthorazi me forcën  e <sub>2</sub>	1,5d <sub>1</sub>	Kur tehu θi ashpërsuar përkatësisht lakuar (për tra bartës të profiluar, kënde etj.).	3-d, ose 9-t
		Në raste të tjera	3-d! ose 6-t


Tabela 6.1 Kriteriume për llogaritjen e radhitjes së farkimeve (vidave)



**$d_1$**  - diametri i farkimit

**e** - dimensione ndërmjet meseve të vrimave të farkimeve (vidave)

**Detalet e** një lidhje janë produktet finale në projektimin e lidhjes.



Shpesh herë për lidhjet e çelikut thuhet se së pari duhet të konstruktohen detalet e lidhjeve, kurse pastaj të llogariten. Detalet vizatohen, më së shpeshti në dimensione të mëdha, edhe atë: 1:10, 1:5, 1:2 dhe më rrallë, në disa raste të veçanta mund edhe në dimensione 1:20 ose 1:25.

Vizatimi i detaleve të konstruksioneve të çelikut është standardizuar.

Fig. 6.5 Lidhja e konsolës me vida

Lloji i materialit	Shenja në projektim	Kufiri i l tërheqjes	Karakteristika themelore të materialit
Materiali themelor	Ç 0361 Ç 0362 Ç 0363	> 235 Mpa	E = 2,1·10 <sup>5</sup> Mpa  G = 8,1·10 <sup>4</sup> Mpa  $\alpha_1 = 12 \cdot 10^{-4}$ cm/1°C
	Ç 0451 Ç 0452 Ç 0453	> 275 Mpa	
	Ç 0561 Ç 0562 Ç 0563	> 355 Mpa	
Farkimet	Ç 0255	R <sub>m</sub> = 300 - 400	
	Ç 0355	R <sub>m</sub> = 380 - 470	
	Ç 0455	R <sub>m</sub> = 440 - 540	
Vidat dhe vidhat	4.6	R <sub>m</sub> = 400 Mpa	
	5.6	R <sub>m</sub> = 500 Mpa	
	6.8	R <sub>m</sub> = 600 Mpa	
	8.8	R <sub>m</sub> = 800 Mpa	

Tabela 6.2 Shtërngimet karakteristike të materialit themelor dhe mjetet lidhëse

### Distanca e farkimeve (vidave) te elementet e konstrukcioneve të çelikut

Që të përcillen forcat më mirë është të fitojnë lidhje sa më të lehta, distancat e farkimeve duhet të jenë sa më të vogla. Ndërkaq, që të jetë lidhja në mënyrë statike e drejtë, këto distanca duhet të plotësojnë kushte të caktuara (kriteriume).

Në fig. 6.6 janë treguar distancat e mundshme të farkimeve (vidave) ndërmjet tyre, nga skaji i elementit nga fërkuesja në drejtim të forcës dhe deri te skaji i elementit deri te farkimi normal i forcës.




Fig. 6.6 Distancat e nevojshme te lidhjet e farkuara

\*e - distanca ndërmjet farkimeve në drejtim të forcës

mln  $e=3 d1$

max  $e=6 d1 (6\delta)$

δ -trashësia e elementit më të hollë në paket

\*e<sub>1</sub> - distanca e farkimeve nga skaji i elementit në drejtim të forcës

mln  $e_1 = 2 d1$

\*e<sub>2</sub> - distanca e farkimit nga skaji i elementit normal në drejtim të forcës

mln  $e_2 = 1,5 d1$ - tehet janë fituar me prerje

mln  $e_2 = 1,3 d1$ - tehet janë fituar me rrokullisje

max  $e_2 = 3d1(6\delta)$

### 6.4 Puna e lidhjes së farkuar dhe lidhjet me vida gjatë ngarkimit statik

Puna statike e farkimeve është e komplikuar për shkak të njëjtës kohë të vepërimit të më shumë llojeve të shtrëngimit:

- shtrëngimi i zhveshjeve;
- shtrëngimi i presionit mbi mbështjellësin e hapjes;
- shtrëngimi i mbështjelljeve;
- shtrëngimi i shtrirjeve.

Dimensionimi i lidhjeve të farkuara qëndron në përcaktimin e numrit të farkimeve dhe radhitjes së tyre në lidhje.

Numri i farkimeve mund të jetë i llogaritshëm ose sipas forcës që vepron në elementin, ose sipas sipërfaqes së prerjes së tërthortë të elementit të njëjtë.

	Rasti i parë i mbingarkimit			Rasti i dytë i mbingarkimit		
Lloji i shtrëngimit	Ç 0361	Ç 0451	Ç 0561	Ç 0361	Ç 0451	Ç 0561
	Ç 0362	Ç 0452	Ç 0562	Ç 0362	Ç 0452	Ç 0562
	Ç 0363	Ç 0453	Ç 0563	Ç 0363	Ç 0453	Ç 0563
$\sigma_{doz}$ -MPa masa	$2 \cdot R_0 / 3 = 0,667 \cdot R_0$			$3 \cdot R_0 / 4 = 0,75 \cdot R_0$		
shtypja	160	185	240	180	205	265
shtypja shtrëngimi						
$\tau_{doz}$ -MPa të lejuara	$2 \cdot R_0 / 3 \cdot \sqrt{3} = 0,385 \cdot R_0$			$2 \cdot R_0 / 4 \cdot \sqrt{3} = 0,433 \cdot R_0$		
	90	105	140	100	120	155 J

Tabela 6.3 Shtrëngimet e lejuara të materialit themelor për rastin e parë dhe të dytë të mbingarkimit

Radhitja e farkimeve varet nga ajo se a thua renditja realizohet te lamelat, këndet ose profilet e çelikut. Sipas kësaj kemi:

a) Renditje te lamelat – te lamelat e holla farkimet radhiten në një rend sipas vijës së farkimeve. Kur gjerësia e lamelës është ( $5d_1 < b < 6d_1$ ).





Fig. 6.7 Radhitja e farkimeve në dy reshta dhe më shumë reshta



Kur gjerësia e lamelës është ( $5d_1 < b < 6d_1$ ) farkimet radhiten në dy reshta, te lamelat me gjerësi më të madhe farkimet radhiten në më shumë reshta, kurse në radhët e fundit (skajet) farkimet vendosen në distanca më të vogla nga rreshtat e mesëm.

Këto krahasime janë treguar në vizatimet në fig. 6.7

b) Radhitja në kënde



Te këndet me gjerësinë e anëve **b** deri më 110 mm merret vetëm një vijë e farkimeve në çdo anë dhe pozita e tij përcaktohet me shprehjen:

$$c = b/2 + 2,5 \text{ mm (5 mm)}$$


Për gjerësitë më të mëdha të anëve miratohen dy vija të farkimeve, ose nëse është **b** mbi 150 mm vendosen edhe farkime shtesë, por distancat e tyre duhet të jenë min  $3d_1$ . Distanca minimale e vijës së farkimeve nga kulmi i këndit, përcaktohet nga kushtet vijuese:

$$C = \frac{5}{2} + 2,50 \text{ (deri 5mm)}$$

- koka e farkimit të mos hyjë në kthesën e këndit;
- të mundet lehtë të gozhdohet farkimi;
- të mundet të realizohet shtimi, kur nën lidhja është kënd tjetër ose çelik i shtypur.


Në figurën (fig.6.9) janë dhënë disa raste për vlerën minimale të distancës **c**.

- pa nën lidhje




$$c_{min} = \delta + R + 0,75d_1$$

- me nën lidhje çelik këndi,



$$c_{min} = \delta_1 + \delta_2 + R + 0,75d_1$$

- me nën lidhje të gërshetuar.



$$c_{min} = \delta + R + 1,5d_1$$

Fig. 6.8 Vlera minimale e distancës së farkimeve **c** për këndin e rëndomtë, kënd me nën lidhje me këndin tjetër dhe kënd me nën lidhje me çelik të gërshetuar

c) **radhitja në profilet e çelikut** – tre profilet e çelikut farkimet mund të radhiten edhe në brinjët edhe në këmbët. Pozita e vijës së farkimeve si dhe diametrat e lejuar të këmbëve janë dhënë në tabelën për profilet e çelikut, për këtë radhitja bëhet vetëm në brinjët, varësisht prej gjerësisë së elementit i cili lidhet me brinjën (fig. 6.9).




Fig. 6.9 Radhitja e farkimeve në brinjët për tra bartës

Ai element mund të jetë faqe ose lidhje dhe i njëjti të jetë i vendosur vetëm në lartësinë e lirë ndërmjet rumbullakësimit të brinjës dhe këmbës (fig. 6.9) ose mund të jetë i ngulur ndërmjet këmbëve (fig. 6.9 b).

### 6.5 Llogaritje e tegelave të ngjitur

Llogaritja e tegelave varet nga ajo se tegeli a është ballor ose këndor.

#### \*Llogaritja e tegelave ballorë




Fig.6.10 Tegelat ballorë

Gjatë dimensionimit të tegelave ballorë merret trashësia e elementit më të hollë i cili lidhet.

Gjatësia e tegelit është e barabartë me gjerësinë e ngjitjes me kusht që ai të jetë realizuar me ndihmën e pllakave të vendosura dhe fundit të lidhjes.

Te këto tegela shtrëngimet llogariten sipas formulës vijuese:

$$\sigma \leq \sigma_{sdoz} = k \cdot \sigma_{doz}$$

K-koeficient i cili varet nga shtrëngimi i kualitetit të tegelit dhe llojit të

### \* Ilogaritja e tegelave këndor

Trashësia minimale e tegelit këndor është **a=3mm**.

Trashësia maksimale varet prej trashësisë së elementeve që saldohen dhe është  $\max a = 0.7 t_{min}$ , ku  $t_{min}$  – është trashësia e elementit më të hollë i cili saldohet (fig. 6.11).




Fig. 6.11 Trashësia e tegelit këndor

Gjatësia e tegelit të I (parë) varet nga mbingarkimi dhe për lidhjen bartëse duhet të jetë në kufijtë **40mm  $\geq l_s \leq 100a$** .

Ky kufizim në vlen te tegelat të trave bartës ndërmjet brinjëve dhe këmbëve. Nëse ndahet tegeli i këndit nga lidhja e salduar do të veprojnë shtrëngimet vijuese:  
 $n$  - shtrëngimi i shtypjes ose shtrirja që vepron normalisht në rrafshinë e lidhjes;

$V_{\perp}$  - Shtrëngimi i zhveshjes që vepron normal në gjatësinë e tegelit në rrafshin e lidhjes;

$V_{II}$  - shtrëngimi i zhveshjes që vepron në drejtim të gjatësisë së tegelit në rrafshin e lidhjes;

$\sigma$  -shtrëngimi i tegelit këndor që llogaritet me ndihmën komponentëve të lartpërmendura:

$$\sigma_u = \sqrt{n^2 + V_{II}^2 + V_{\perp}^2} \leq \sigma_{\bar{s}, doz}$$


## Lidhja e realizuar me saldime anësore

### 6.6 Lidhjet e ngarkuara aksiale

Llogaritjen e kësaj lidhje do ta realizojmë sipas shprehjeve dhe rregullave në standardet e mëparshme të dhëna.

Lidhja është ngarkuar me një forcë aksiale të shtrëngimit  $F$ , kurse ngjitja është realizuar përmes dy saldimeve anësore me trashësi  $a$  dhe gjatësinë  $l$ .

### Lidhja e realizuar me saldime çeliku



Lidhja është e ngarkuar me forcë aksiale të shtrëngimit  $F$ , kurse është realizuar me dy saldime këndore të çelikut.

Lidhja është simetrike dhe forcën e përgjithshme  $F$  përmes saldimeve përcillet në të dy lamelat me nga gjysma nga vlera e tyre  $F/2$ .

Për llogaritjen shfrytëzohen shprehjet:

$$\sigma_u = \sqrt{n^2 + V_{\perp}^2 + V_{II}^2} \leq \sigma_{s, doz} = 0,5R_m / v$$


Në rast është:  $n=V_{II} = 0$ , rrjedh se e  $\sigma_u = V_{\perp} = F/A_s$  ku

$$A_s = \sum al = 2al \text{ dhe përfundimisht rrjedh se është:}$$

$$\sigma_u = F/2al \leq 0,5R_m / v$$

**Shembulli nr.1** Përcaktoni diametrin e fuqisë bartëse të vidës së përpunuar 4.6 (e dhënë në figurë). Elementet themelore nga materiali C 0361.

1. Zgjidhja e nën lidhjes  
 $2 \neq 50.8$
2. Zgjedhja e diametrit të farkimit



I shfrytëzojmë të dhënat të dhëna në tabelën 4.5 për vidhën 4.6 dhe materialin themelor C 0361 (tabela 4.2).

- presioni sipas mbështjellësit të vrimës  $\sigma_{p_{doz}} = 2 \cdot \sigma_{doz(l)} = 320 \text{ Mpa}$

- hvidhosja e vidës  $\tau_{doz} = 0,35 Rm = 140 \text{ Mpa}$

Diametrin e vidës do ta përcaktojmë sipas trashësisë të elementeve që ndijnë në lidhje.

$$d_{1\max} = 8 + 10 = 18 \text{ mm}$$

dhe

$$d_{1\max} = \sqrt{5 \cdot 0,8} - 0,2 = 1,8 \text{ cm}$$

### 3. Dimenzionimi i lidhjes

Është miratuar vida e përpunuar M 16 fuqia bartëse e së cilës është:

$N\tau_2 = \frac{\pi \cdot d^2}{2} \tau_{doz}$  për zhveshjen (zhveshja është pas dy sipërfaqeve të doz zhveshja – vida dy sjellëse)

$$N\tau_2 = \frac{\pi \cdot d^2}{2} \tau_{doz} = \frac{3,14 \cdot 1,6^2}{2} \cdot 14 = 56,27 \text{ kN}$$

$$N\rho = d \cdot t \cdot \sigma_{p_{doz}} = 1,6 \cdot 1,6 \cdot 32 = 81,92 \text{ kN}$$

Si vlerë e sigurt për fuqinë bartëse merret vlera më e vogël nga dy vlerat e fituara për fuqinë bartëse:  $N\tau_2 = 56,27 \text{ kN}$

$$N_{mer} = N\tau_2 = 56,27 \text{ kN}$$



## 6.7 Shtimi i këndeve

Kjo shtesë zakonisht mbulohet direkt dhe njëanshëm me lidhje **këndore** ose **çelik** të shtypur edhe atë zakonisht nga ana e brendshme.




Fig. 6.11 Shtesat me kënd lidhor

Nën lidhja këndore patjetër të përpunohet për shkak të radiusit të zhveshjes së këndit, që të sigurohet shtrat të krahëve të këndit. Te prerjet e ndërlikuara lidhja këndore merret për anë më e vogël nga këndi i dhënë ose lëshimi pritet. Me këtë rast nën lidhja duhet të jetë me trashësi më të madhe. Zgjedhja e lidhjes këndore varet nga mbingarkimi dhe kryhet nga kushti për sipërfaqe.

Te këndet e shtrënguar gjithashtu patjetër të plotësohet kushti neto sipërfaqen d.m.th. neto sipërfaqja të këndit i cili shtohet duhet të jetë e barabartë me sipërfaqen neto të nën lidhjes.

Te këndet e shtrydhura gjithashtu patjetër të plotësohet kushti për sipërfaqe, por këtu bëhet zgjedhja sipas bruto sipërfaqeve.



Gjatë shtimit distanca e farkimeve arrin prej 3 deri më  $3,5d_1$ .


Në vendet ku ndërpriten këndet, nën lidhja e pranon tërë fuqinë, kurse distanca prej 3 deri  $3,5d_1$  çdoherë janë më të vogla nga distancat e sigurta për të ashtuquajturën prerje e tërthortë.

Për këtë shkak, gjatë zgjedhjes së nën lidhjes patjetër të mbahet llogari se ajo çdoherë dobësohet për dy vrima të farkimeve. Numri i caktuar i farkimeve shpërndahen në varshmëri prej gjerësisë së skajeve, edhe atë te këndet krahë barabartë të ketë numër të njëjtë të farkimeve në çdo anë, kurse te brinjë të ndryshëm në varshmëri prej gjerësisë së skajeve.

**Shembulli nr.1:** Një shtrirje (2L60.60.6) është e lidhur me pjesën tjetër nga konstrukcioni nëpërmjet lastrës nyjore ( $t=12\text{mm}$ ) me farkime të rëndomta të përpunuara (M 16 klasa 5.6). Përcaktoni vlerën maksimale të forcës  $F=?$  në shtrirjen:

Janë të dhëna edhe: materiali prej çeliku C 0361

$$\sigma_{doz(I)} = 160\text{MPa}, \tau_{doz} = 175\text{MPa}, \sigma_{pdoz} = 370\text{MPa}$$



Farkimet janë të dyanshme, fuqia bartëse e zhveshjes është:

$$N\tau_2 = \frac{\pi \cdot d^2}{2} \tau_{doz} = \frac{3,14 \cdot 1,6^2}{2} \cdot 17,5 = 4,02 \cdot 17,5 = 70,35\text{kN}$$

Fuqia bartëse e presionit pas mbështjelljes së vrimës (birës) është:


$$N\rho = d \cdot t \cdot \sigma_{pdoz} = 1,6 \cdot 1,2 \cdot 37 = 71,04\text{kN}$$

E vlershme për përcaktimin e forcës  $F$  është fuqia bartës e një zhvidhosje e zhveshjes ( $N\tau_2 < N\rho$ )

$$F = 2 \cdot N\tau_2 = 2 \cdot 70,35 = 140,7\text{kN}, \text{ e miratuar } F_{\text{max}} = 140\text{kN}$$

### 6.8. Shtimi i trarëve bartës të profiluar

Shtimi i trarëve bartës bëhet sipas principeve të njëjta sikurse te lamelat dhe këndet. Me ç'rast duhet të bëhet mbulimi edhe të brinjëve edhe të këmbëve edhe atë ose sipas forcave që veprojnë mbi to ose sipas sipërfaqeve (kushti i sipërfaqeve). Sipas kushtit të sipërfaqeve bëhet barazimi i neto sipërfaqes të nënlidhjes përkatësisht sipërfaqja e reduktuar e farkimeve dhe neto sipërfaqet e pjesës që shtohet.



Brinja e profilit zakonisht mbulohet dyanshëm, kurse këmbët me një anë.

Te shtimi i profileve të çelikut me kombinimin e më shumë elementeve në një fitohet e a.q. prerja e përbërë me të cilin mundet të arrihet procese me sipërfaqe më të mëdha. Gjatë kësaj elementet e prerjes së përbërë mundet të jenë të vendosura në distanca ndërmjet tyre ose farkuara.

Për shkak të mbajtjes së lidhjeve si më e mirë konsiderohet kur elementet ndërmjet tyre janë të lidhura d.m.th. farkuara.

Për pjesët e shtrënguara në llogaritjet merren neto, kure për të shtrënguarit karakteristikat bruto gjeometrike të prerjes.

Sipërfaqja e reduktuar e farkimeve fitohet në raport me tërheqjet

$$\sigma : \tau : \rho = 1 : 0,8 : 2,0$$

ku është:

$$A_{\tau, rz} = \frac{\pi \cdot d_1^2}{4} \tau_{doz}, \quad \tau_{doz} = 0,8 \cdot \sigma_{doz}$$

$$A_{\rho, rz} = d_1 \cdot t_{\min} \cdot \rho_{doz}, \quad \rho_{doz} = 2,0 \cdot \sigma_{doz}$$

Për sipërfaqen me vlerë merret ajo që është më e vogël, dhe sipas saj përcaktohet numri i farkimeve.

$$n = A_{op} / A_{r, z \min}$$

Numri i vidhave për lidhjet plotësisht të mbuluara te tratë bartës përcaktohet në varshmëri nga tipi i vidhave, se a janë me shtretër të saktë (përpunuar) ose pa shtretër të saktë (jo të punuar) dhe ngarkimet rastësishme.

$$n = W_{op} / W_{r, z \min}$$

ku janë:

$n$  - numri i farkimeve

$W_{op}$  – element rezistues i lidhjeve

$W_{r,zmin}$  – moment i reduktuar rezistues për farkimet ose vidat

**Shembull 1:** Të llogaritet dhe konstruohet shtesa e shkopit aksial të shtrënguar e përbërë prej një lamele  $\neq 325.20$ , ashtu që fuqia bartëse në zonën jashtë shtesës dhe fuqia bartëse në zonën e shtesës të jetë e njëjtë. Shtesa të realizohet me farkime. Materiali C 0361 është rasti i parë i ngarkesës.

### 1. Përcaktimi i dimensioneve të nën lidhëseve

Prej kushtit për lidhjet plotësisht të mbuluara  $A_n^o \leq A_n^p$  dhe supozimet e diametrit të farkimeve  $d_1=23\text{mm}$  me dobësim të prerjes me katër vrima (birave) fitohet:

$$A_n^o = 32,5 \cdot 2,0 = 65\text{cm}^2 - \text{neto sipërfaqja e prerjes themelore}$$

$$A_n^p = A_o = 32,5 \cdot 2 \cdot 1,4 - 4 \cdot 2 \cdot 2,3 \cdot 1,4 = 65,24\text{cm}^2 - (A_n^o < A_n^p)$$

Janë miratuar dy nën lidhje **2  $\neq$  325.14**

### 2. Përcaktimi i diametrit të farkimeve

$$d_{1max} = t_{min}/2 + 16 = 14/2 + 16 = 7 + 16 = 23 \text{ mm}$$

$$d_{1max} = \sqrt{5 \cdot 1,4} - 0,2 = 2,44\text{mm}$$

diametri i miratuar i farkimit  $d_1 = 23\text{mm}$

### 3. Përcaktimi i numrit të farkimeve

$$A_{\tau_{2,r}} = \frac{d_1^2 \cdot \pi}{2} \tau_{doz} = \frac{2,3^2 \cdot 3,14}{2} \cdot 0,8 = 6,64\text{cm}^2 = A_{mer}$$

$$A_{\rho_r} = d_1 \cdot t \cdot \sigma_{pdoz} = 2 \cdot 2,3 \cdot 2 = 9,2\text{cm}^2$$

$$n = \frac{A_n^o}{A_{\tau_{2,r}}} = \frac{65}{6,64} = 9,79$$


miratohet:  $4 \times 3 = 12$  farkime me  $d_1 = 23\text{mm}$

## 4. Shpërndarja e farkimeve miratohet:

